

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njësia Org. Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No:
Nr. i Enqesës Proj. Struktura	Data Date:
No. origjal	
PRISHTINE/A NO.1	

01/3 1663 31.08.26

RAPORT I PUNËS

PËR TREMUJORIN
E DYTË TË VITIT

2026

TABELA E PËRMBAJTJES

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV	6
1.1. HYRJE	6
1.2. AKTIVITETET KRYESORE	8
1.3. VENDIME DHE AKTE TË TJERA	12
2. BORDI I DREJTORËVE	15
2.1.VENDIMET E BORDIT TË DREJTORËVE	15
3. KOMISIONI I AUDITIMIT	17
3.1. VENDIMET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT	17
3.2. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PUNËS SË ZYRTARIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PERIUDHËN E TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2026	17
4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV	18
4.1. ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE	19
4.1.1. STRUKTURA E TË PUNËSUARVE	19
4.1.2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE PËRMBYLLJA E KONKURSEVE	20
4.2. ZYRA LIGJORE	20
4.3. ARKIVI	21
5. DEPARTAMENTI FINANCIAR	23
5.1. AKTIVITETET KRYESORE	23
5.2. SHQYRTIMI I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE	23
5.2.1. PRODHIMI I UJIT NË M3	23
5.2.2. FATURIMI I UJIT NË M³	24
5.2.3. FATURIMI I UJIT NË EURO (€)	24
5.2.4. ARKËTIMI I UJIT/€	25
5.2.5 PËRQINDJA E ARKËTIM	25
5.3. DRAFT PASQYRAT FINANCIARE PËR TM2/2026	33
6. ZYRA E PROKURIMIT	43
7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT	44
7.1. CILËSIA E UJIT	44
8. DEPARTAMENTI TEKNIK	47
8.1 AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORIT TEKNIK	47
8.2. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT	48
8.2.1 FURNIZIMI ME UJË DHE DEFECTET E PARAQITURA	48

8.2.2. IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT FLOWS.....	49
8.2.3. SASIA E UJIT TË PRODHUAR, UJIT TË FATURUAR DHE HUMBJEVE TË UJIT	49
8.3 DIVIZIONI PËR MIRËMBAJTJEN E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT.....	52
8.3.1. DMA - ZONAT	54
8.4. DIVIZIONI PËR MIRËMBAJTJEN E RRJETIT TË KANALIZIMIT.....	56
8.5 DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE	57
8.5.1. AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2026.....	57
8.5.2 PROJEKTI FLOWS (NXITJA DHE SHFRYTËZIMI I MUNDËSIVE PËR SIGURINË E UJIT)	57
8.5.3 PROJEKTI ITUN (IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA)	57
RAPORT PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE PËR TM2/2026	59

TABELAT

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2026	8
Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2026.....	12
Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM2/2026.....	19
Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM2/2026	20
Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM2/2026.....	20
Tabela 6. Numri i dokumenteve administrative të protokolluara sipas njësive gjatë periudhës së TM2/2026	21
Tabela 7. Numri i dokumenteve (faturave) të protokolluara gjatë periudhës së TM2/2026.....	22
Tabela 8. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m ³	23
Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m ³	24
Tabela 10. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)	24
Tabela 11. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit/€	25
Tabela 12. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit	25
Tabela 13. Paraqitja grafike e shpenzimeve në euro (€)	26
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për region TM2/2026 dhe TM2/2025 dhe plani TM2/2026.....	27
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative të Gjilanit TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025	29
Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësine Operative të Kamenicës TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025	30
Tabela 17. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative në Vitisë për TM2/2026, krahasimi me TM2/2025	31
Tabela 18. Treguesit – shpenzimet operative për TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025	32
Tabela 19. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera.....	37
Tabela 20. Stoket.....	37
Tabela 21. Pasuritë tjera afatshkurta	38
Tabela 22. Pronat, impiantet dhe pajisjet.....	38
Tabela 23. Llogaritë e pagueshme.....	39
Tabela 24. Detyrimet tjera afatshkurta	41
Tabela 25. Të hyrat e shtyra / grantet	41
Tabela 26. Ekuiteti	41
Tabela 27. Të hyrat	41
Tabela 28. Shpenzimet e shpërndarjes.....	41
Tabela 29. Shpenzime administrative të tjera.....	49
Tabela 30. Fitimi (humbja) para tatimit	42
Tabela 31. Ndryshimet në ekuitet	42
Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – vlerë minimale	43
Tabela 33. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – “kuotim i çmimit”	43
Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – “procedurë e hapur – vlerë e mesme”	43
Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – “procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës – vlerë e mesme”	43
Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2026 për komuna	49
Tabela 37. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2026	50

Tabela 38. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM2/2026	52
Tabela 39. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM2/2026 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit	55
Tabela 40. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2026	56
Tabela 41. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2026	56
Tabela 42. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM2/2026	57

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	37
Shënimet shpjeguese 2. Stoqet	37
Shënimet shpjeguese 3. Pasuritë tjera afatshkurta	38
Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet	38
Shënimet shpjeguese 5. Investimet në vijim/projektet	38
Shënimet shpjeguese 6. Llogaritë e pagueshme për TM2/2026	39
Shënimet shpjeguese 7. Detyrimet tjera afatshkurtra	40
Shënimet shpjeguese 8. Të hyrat e shtyera/grantet	41
Shënimet shpjeguese 9. Ndryshimi në ekuitet	41
Shënimet shpjeguese 10. Të hyrat	41
Shënimet shpjeguese 11. Shpenzimet e shpërndarjes	41
Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet administrative të tjera	41
Shënimet shpjeguese 13. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit	42

FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE

ARRU	Autoriteti Rregullator i Ujërave
B.I.	Biznes Individual
DMA zona	District Metered Area (Zona e Matjes së Rrjetit/Ujësjiellësit)
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

FLWS	Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security (shqip: Nxitja dhe Shfrytëzimi i
Mundësive	për Sigurinë Ujore)
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GIS	Geographic Information System (Sistemi Gjeografik i Informacionit)
GOPA	Gesellschaft für Organisation, Planung und Ausbildung (Shoqëria për Organizim, Planifikim dhe Trajnim).
HM	Hidromorava
IKSH	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IMF	Institucionet mikrofinanciare
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
KESCO	Kompania për shpërndarjen e Energjisë Elektrike të Kosovës
KIWER	Kosovar Institute for Water and Environmental Research (Instituti Kosovar për Kërkime në Fushën e Ujit dhe Mjedisit)
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NTSh	Ndërmarrje Tregtare Shoqërore
Nj.O.	Njësi Operative e KRU Hidromorava Sh.A.
Sh.A.	Shoqëri Aksionare
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
SHUKOS	Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
SHUKALB	Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimeve të Shqipërisë
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UPF	Uji i pafaturuar
OE	Operator Ekonomik
WRIPS	Water Resources Investment Preparation Study under the FLOWs Project in Kosovo - Studimi
Përgatitor	i Investimeve në Burimet Ujore në kuadër të Projektit FLOWs në Kosovë.

FJALORI I TERMAVE TEKNIK TË PËRDORUR

Gypat AC	Gypat prej azbest/cementi
Gypat HDPE	Gypat prej polietileni të fortë dhe të qëndrueshëm
Gypat DN 80 mm	Gypat me diametër nominal 80 milimetra
Gypat PE	Gypat prej polietileni

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Ky raport i referohet periudhës raportuese të tremujorit të dytë të vitit 2026 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative të Ndërmarrjes, si dhe me përshkrimin e arritjeve të caqeve të Planit të Biznesit të KRU "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan.

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026 Ndërmarrja ka vazhduar të përballet me një sërë sfidash të natyrës teknike, operative dhe financiare, të cilat kanë ndikuar në menaxhimin efikas të resurseve dhe në realizimin e objektivave strategjike të përcaktuara.

- **Menaxhimi i prodhimit dhe furnizimi me ujë:** Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 kemi pas kërkesë normale për furnizim me ujë dhe kemi arritur të kemi një furnizim shumë të mire dhe pothuajse pa ankesa nga konsumatorët.
- **Menaxhimi i humbjeve të ujit:** Mbetet një sfidë e vazhdueshme për Kompaninë dhe për të ardhur deri te rezultatet e dukshme nevojiten investime, si në rrjet të ujësjellësit, po ashtu edhe në ndërrim të ujëmatësve të vjetër, në krijimin e DMA zonave të reja, në vendosjen e pajisjeve për menaxhim të presionit etj, të cilat i kemi parapa në investime në Planin e Biznesit 2026-2028. Përveç humbjeve teknike, nevojitet një fokus i madh edhe në humbjet komerciale, në luftimin e keqpërdoruesve të ujit përmes lidhjeve ilegale, për çka edhe kemi parapa një ekip të veçantë për këtë aktivitet, në punëtorin e fundit me Bordin e Drejtorëve, me që rast edhe i kemi parapa ndryshimet në "Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës".
- **Inkasimi i borxheve të vjetra:** Mbetet sfidë e vazhdueshme pasi që kemi të bëjmë me një kategori të konsumatorëve që nuk kanë paguar për një kohë të gjatë dhe është e vështirë që të binden për pagesë, pasi që edhe ligji për marrëdhëniet detyimore e lejon parashkrimin e borxheve më të vjetra se një vit. Në këtë aspekt jemi duke e zbatuar "Planin e Veprimit" për vitin 2026 dhe përveç aktiviteteve të zakonshme kemi filluar edhe vizitat me prezencë të policisë të konsumatorëve të cilët nuk kanë lejuar shkyçjen nga rrjeti i ujësjellësit për shkak të borxheve të pa paguara.
- **Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Fabrikave të Prodhimit (Përlepnica, Velekincë dhe Letnicë)** – Është një sfidë e madhe për Kompaninë, pasi që në këto fabrika pothuajse nuk është investuar fare për një kohë të gjatë, si dhe nuk ka pas mirëmbajtje të rregullt të tyre. Në fabrikën në Përlepnica përveç që ka munguar mirëmbajtja e rregullt, nuk ka pasur as investime që nga viti 2004, në Fabrikën në Velekincë po ashtu nuk ka pasur mirëmbajtje të rregullt dhe investime që nga viti 2014 (me përjashtim të një investimi të vogël për mirëmbajtje në vlerë prej 150k nga ME gjatë vitit 2024), në Fabrikën në Letnicë gjithashtu nuk ka pasur investime e as mirëmbajtje të rregullt që nga lëshimi në punë i fabrikës në vitin 2002). Duke marrë parasysh tarifat e ulëta, të ndikuara edhe nga inflacioni i 3 viteve të fundit, e në anën tjetër kostos së lartë për të investuar në fabrika, ka qenë pothuajse e pamundur që ky investim të bëhet me mjete vetanake deri më tani, por me ngritjen e tarifave, nga viti 2026 e tutje, duhet të japim prioritet investimeve në fabrika me pajisje të teknologjisë së re dhe pastaj të ketë edhe mirëmbajtje të rregullt të tyre.
- **Menaxhimi i projekteve të shumta paralele:** Sfiduese mbetet edhe menaxhimi efikas i një numri të madh të projekteve – si ato të financuara nga të hyrat e Kompanisë, projektet me Ministrinë e Ekonomisë, si dhe projektet në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadër të programit FLOWS, i cili tashmë ka hyrë në fazën e zbatimit në terren me PAKO-n 1 dhe PAKO-n 2, si dhe projekti me EBRD dhe EIB për ITUN, ku pas nënshkrimit të dy Marrëveshjeve, asaj për ndërtim të kolektorëve në gjatësi prej 12.5 km, si dhe Kompanisë Mbikëqyrëse për mbikëqyrje të punimeve, tani me kanë filluar edhe punët në terren.

Përkundër këtyre sfidave, Ndërmarrja mbetet e përkushtuar në zbatimin e masave konkrete për përmirësimin e funksionimit operativ dhe garantimin e furnizimit cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2026

Nr.	Institucioni	Data	Qëllimi i takimit
1.	MF/ME/EBRD	02.04.2026	Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e ME, MF, EBRD dhe KRU "Hidromorava" si përfituese e projektit. Gjatë takimit është diskutuar lidhur me vonesat në pagesat për Operatorin Ekonomik (OE) të projektit ITUN, me qëllim shmangien e penaltiteve që mund të rrjedhin nga moskryerja me kohë e obligimeve financiare. Palët pjesëmarrëse janë dakorduar që të veprohet me urgjencë dhe koordinim të plotë, në mënyrë që sa më shpejt të realizohen pagesat për të gjitha faturat e dorëzuara deri më tani nga OE i projektit.
2.	SHUKOS	15.04.2026	Është mbajtur mbledhja e rregullt e Bordit të SHUKOS, ku përveç pikave të zakonshme të rendit të ditës, është diskutuar edhe organizimi i Kuvendit të SHUKOS. Është theksuar se Kuvendi duhet të mbahet më së largu deri në fund të muajit prill, në mënyrë që të respektohet afati ligjor i përcaktuar.
3.	BB/FLWS	16.04.2026	Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore dhe përfaqësuesit e projektit FLWS, ku është diskutuar progresi i punimeve në kuadër të këtij projekti. Pas takimit është realizuar edhe vizitë në terren të punimeve, gjatë së cilës është bërë inspektimi i aktiviteteve të deritanishme. Përfaqësuesit e Bankës Botërore janë shprehur të kënaqur me dinamikën e zhvillimit të punimeve si dhe me cilësinë e punimeve të realizuara deri në këtë fazë të projektit.
4.	EBRD/ITUN	21.04.2026	Në takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e projektit FLWS, JV EREN & AK Invest, përfaqësuesit e Mbikëqyrjes si dhe KRU "Hidromorava" si përfituese e projektit. Gjatë takimit është diskutuar çështja e kyçjeve individuale në Kamenicë, të cilat nuk kanë qenë të parapara në projekt gjatë ndëimit të gypit kryesor.

			Në këtë drejtim është vlerësuar nevoja për trajtimin e kësaj çështjeje si punë shtesë. Është dakorduar që ekipet e Operatorit Ekonomik (punëkryes), në bashkëpunim me ekipet e Mbikëqyrjes dhe KRU "Hidromorava", të përgatisin projektin për kyçjet individuale, duke specifikuar numrin e kyçjeve si dhe koston për realizimin e kësaj pune shtesë.
5.	BB/FLOWS	27.04.2026	Është mbajtur takimi i progresit për projektin e ITUN, gjatë të cilit Operatorit Ekonomik (punëkryes) ka prezantuar se ndërtimi i kolektorëve është duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë. Megjithatë, është theksuar se punimet janë detyruar të ndërpriten për shkak të mosrealizimit të pagesave për situatat e përfunduara deri më tani, gjë që ka ndikuar në likuiditetin e Operatorit Ekonomik (punëkryes).
6.	EBRD	28.04.2026	Në takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e EBRD nga Londra, përfaqësuesit e EBRD nga zyra në Kosovë, si dhe përfaqësuesit e KRU "Hidromorava" si përfituese e projektit. Gjatë takimit është diskutuar për dinamikën e zhvillimit të punimeve në ndërtimin e kolektorëve, si dhe nevojën që sa më shpejt të realizohen pagesat për situatat e dorëzuara deri më tani. Gjithashtu, është theksuar domosdoshmëria e zhvillimit të takimeve sa më të shpejta me përfaqësuesit e Aksionarit dhe Qeverisë, me qëllim sigurimin e fondeve shtesë për ndërtimin e Impiantit. Në këtë kontekst është vlerësuar se sigurimi i fondeve është edhe obligim ligjor në bazë të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend, në mënyrë që të mundësohet nënshkrimi sa më i shpejtë i kontratës dhe fillimi i punimeve për ndërtimin e Impiantit. Në fund të takimit është realizuar edhe vizitë në terren të punimeve për ndërtimin e kolektorëve, ku përfaqësuesit e EBRD nga Londra janë shprehur shumë të kënaqur me dinamikën dhe cilësinë e punimeve të realizuara deri më tani.
7.	ME/NJPMNP	28.04.2026	Është mbajtur takim me zëvendësministrin e Ministrisë së Ekonomisë lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes për pagesat nga kredia me EBRD. Gjatë takimit është bërë e ditur se është hapur ruga për procedimin e situatave të dorëzuara nga Operatori Ekonomik (punëkryes) për pagesë nga kredia e EBRD.

8.	ARRU	13.05.2026	Në këtë takim kanë marr pjesë të gjithë KE-të e KRU-ve, ku si temë kryesore e takimit ka qenë që të fillohet me përgatitjet për procesin e licencimit të kompanive të ujit. Si përfundim, është marrë vendim që të formohen grupet punuese nga të gjitha KRU-t dhe menjëherë të fillohet me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim.
9.	SHUKOS-SHUKALB	14/15.05.2026	Është mbajtur mbledhja e rregullt vjetore e Bordit SHUKOS-SHUKALB, ku përveç prezantimit të rezultateve të arritura gjatë konferencës së vitit 2025, është diskutuar edhe për organizimin e konferencës për vitin 2026, e cila kësaj radhe do të mbahet në Prishtinë, në javën e parë të muajit nëntor.
10.	Ministria e Ekonomisë	19.05.2026	Është realizuar vizite nga Ministria e Ekonomisë në KRU "Hidromorava", me ç'rast Ministria është njoftuar për performancën dhe të arriturat e Kompanisë gjatë vitit të kaluar, si dhe në fund është realizuar edhe një vizitë në Fabrikën e Prodhimit të Ujit në Përlepnice, ku edhe është njoftuar me dinamikën e zhvillimit të punimeve të projektit FLOWS.
11.	Autoriteti Rregullativ i Ujërave (ARRU)	28.05.2026	Është mbajtur dëgjimi publik në zyrat e ARRU në lidhje me Draft "Rregulloren për Përcaktimin e Tarifave për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë", me ç'rast edhe i kemi dhënë komentet tona të gjithë përfaqësuesit e KRU-ve, si dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë aktivitet.
12.	Banka Botërore	01.06.2026	Takim me përfaqësuesit e projektit FLOWS, Operatorin Ekonomik (OE) dhe Kompaninë Mbikëqyrëse të projektit, gjatë të cilit është diskutuar progresi i arritur në kuadër të Pakos 2. Në takim janë trajtuar aktivitetet që përfshijnë ndërtimin e Implantit të Trajtimit të Ujit në Letnicë, shtrirjen e gypave në Kamenicë, si dhe realizimin e linjës së gypit nga liqeni i Përlepnices deri te impianti i trajtimit të ujit.
13.	Banka Botërore	16.06.2026	Është mbajtur takimi i progresit të punimeve në kuadër të Pakos 2, me ç'rast Operatori Ekonomik (OE) dhe Kompania Mbikëqyrëse kanë prezantuar dizajnet e projektit për Implantin e Trajtimit të Ujit në Letnicë, dizajnin e "Linjës Zero", e cila përfshin gypin transportues nga liqeni deri te impianti, si dhe dizajnin për kyçjet individuale të konsumatorëve në Komunën e Kamenicës.

14.	Bordi i Drejtorëve	17-19.06.2026	Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Kompanisë kanë mbajtur Punëtori në Strugë, gjatë së cilës është punuar dhe është aprovuar Ri-shikimi i Planit të Biznesit për vitin 2026, si dhe "Rregullorja për Operimin, Monitorimin dhe Mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Shfrytëzimit të Ujit në KRU "Hidromorava" Sh.A." Gjithashtu, në përfundim të punëtorisë është mbajtur mbledhja e gjashtë e rregullt e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë shqyrtuar dhe aprovuar pikat e parapara sipas rendit të ditës.
15.	Qeveria e Kosovës / ZKM	26.06.2026	Në kuadër të misionit të Komizës Investive për Ballkanin Perëndimor (WBIF) në Kosovë dhe bazuar në temat e parapara në agjendën e takimit, KRU "Hidromorava" Sh.A. është kërkuar të përgatisë një përmbledhje lidhur me progresin e punimeve në projektin "Ndërtimi i Kolektorëve" dhe projektin e Ndërtimit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN). Në këtë takim, KRU "Hidromorava" Sh.A. është përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Njësia për Implementimin e Projektit (PIU), të cilët kanë prezantuar progresin e arritur në realizimin e punimeve për ndërtimin e kolektorëve. Gjithashtu, është bërë e ditur se për projektin e Ndërtimit të ITUN-it kanë përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është pranuar miratimi ("No Objection") nga EBRD. Megjithatë, kontrata ende nuk është nënshkruar për shkak të mungesës së fondeve të nevojshme për financimin e projektit. Rritja e kostos së përgjithshme të projektit është ndikuar nga lëvizjet e çmimeve në tregun ndërkombëtar pas pandemisë, luftës në Ukrainë dhe konfliktit të fundit në Iran, të cilat kanë reflektuar në rritjen e çmimeve të materialeve dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin e projektit.
16.	SHUKOS	29.06.2026	Është mbajtur takimi i rregullt i Bordit të SHUKOS-it, në të cilin, përveç pikave të parapara të rendit të ditës, është diskutuar edhe lidhur me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet SHUKOS-it dhe Institutit për Ujëra dhe Inovacion. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përgatitja e elaborateve për burimet ujore, të cilat do të shërbejnë si bazë për aplikimin për lejet ujore për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

17.	ARRU	29.06.2026	Është mbajtur takim në ARRU, ku çështja kryesore e diskutimit ka qenë pajisja e Kompanive Rajonale të Ujësllësit (KRU) me licencat e reja për ofrimin e shërbimeve të ujësllësit dhe kanalizimit. Me këtë rast, të gjitha KRU-të janë njoftuar se, paraprakisht, duhet të aplikojnë dhe të pajisen me lejet ujore përkatëse, ndërsa më pas të aplikojnë për pajisjen me licencat për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit.
18.	Komuna Kamenicë	30.06.2026	Është mbajtur takim me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, ku temë kryesore e diskutimit ka qenë furnizimi me ujë gjatë muajve të verës, periudhë në të cilën pritet rritje e kërkesës për ujë si rezultat i ardhjes së bashkatdhetarëve. Gjithashtu, janë diskutuar projektet që janë në proces të realizimit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Komunën e Kamenicës, si dhe hapat e mëtejshme për implementimin e tyre.

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ka nxjerrë 22 vendime të renditura si më poshtë:

Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2026

Nr.	Vendimi	Numri i Vendimit	Data e protokollimit
1.	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për të punësuarin A. M. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Mirëmbajtës i pajisjeve elektromekanike pranë KRU "Hidromorava" Sh.A, në Gjiilan, nga data 02.04.2026, në përputhje me kërkesën e tij për dorëheqje të datës: 02.04.2026.	383/1	02.04.2026
2.	Vendim për dhënien e ndihmës solidare ndaj të punësuarit M.D. i caktuar në punët dhe detyrat punuese "Operator në S.P. "Baja", me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (prindit), duke në vlerë prej 200 €, bazuar në nenin 18. të "Rregullores mbi kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar, dhënien e ndihmave solidare".	414	08.04.2026
3.	Vendim lejimin e regjistrimit të konsumatorëve të fshatit Uglarë, Komuna Gjiilan, pa aplikimin e ngarkesës tarifore për kyçe në rrjetin e ujësllësit.	428	16.04.2026
4.	Vendim për punëtorët e rrjetit të kanalizimit A.S., B.R., E.S., H.S., XH.R., M.S. dhe A.H., që në vend të shfrytëzimit të sasisë së qumështit gjatë	430	17.04.2026

	punës të kompensohen në vlerë monetare prej 15.00 € në muaj, duke filluar nga muaji mars 2026 e në vazhdim.		
5.	Vendim për aprovimin e kërkesës së Menaxherit të Divizionit për Planifikim dhe Menaxhimin e Projekteve për pjesëmarrje në trajnimin "GDI Solutions Conference 2026", i cili është organizuar në Zagreb, Republikën e Kroacisë, në periudhën 22-24 prill 2026, me qëllim përfitimin e praktikës përmes studimeve reale, prezantimeve dhe diskutimeve interaktive, si dhe eksplorimin e përdorimit të platformave ArcGIS dhe GD Ensemble në përmirësimin e vendimmarrjes dhe menaxhimit të infrastrukturës.	440	20.04.2026
6.	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave sipas konkurseve publike nr. 397, 405 dhe 406, të datave 07.04.2026 dhe 08.04.2026, për pozitat Punëtor fizik i pakualifikuar – punëtor fizik në ujësjellës, Mirëmbajtës i pajisjeve elektro-mekanike dhe Ujë instalues/mjeshtër.	467	23.04.2026
7.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues sipas konkursit publik nr. 405, të datës 08.04.2026, për vlerësimin e kandidatëve në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese Mirëmbajtës i pajisjeve elektro-mekanike në KRU "Hidromorava" SH.A., njësia punuese në Kamenicë.	468	23.04.2026
8.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues sipas konkurseve publike nr. 397 të datës 07.04.2026 dhe nr. 406 të datës 08.04.2026, për vlerësimin e kandidatëve në procedurën e rekrutimit për pozitat punuese Punëtor fizik i pakualifikuar – punëtor fizik në ujësjellës, si dhe Ujë instalues/mjeshtër në KRU "Hidromorava" SH.A., njësia punuese në Kamenicë.	469	23.04.2026
9.	Vendim që i punësuari Xhevat Rashiti, nga pozita "Operator i mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit", sistemohet në pozitën "Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda", në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 18, pika 1 të Rregullores për themelimin e marrëdhënies së punës në KRU "Hidromorava" Sh.A.	503	06.05.2026
10.	Vendim për shpalljen e konkursit të brendshëm për plotësimin e vendit të lirë të punës në KRU "Hidromorava" Sh.A. për pozitën: Përgjegjës i Autoparkut, bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenin 4 të Rregullores Nr. 1273, datë 05.12.2011 për themelimin e marrëdhënies së punës, si dhe nenin 5, pika 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.	525	08.05.2026
11.	Vendim që i punësuari Xhevdet Biçkaj, nga pozita "Punëtor fizik në rrjetin e kanalizimit në Nj.O. në Kamenicë, sistemohet në detyrat punuese si: "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave, në Njësinë Operative në Kamenicë", konform nenin 17. të Ligjit nr. 03/L-212 të punës, dhe nenit 18. pika 1. të Rregullores mbi themelimin e marrëdhënies së punës në KRU "Hidromorava" - SH.A.	539	12.05.2026
12.	Vendim për caktimin e personave përgjegjës për pjesëmarrje në grupin punues për përgatitjen e dokumentacionit për Leje Ujore dhe Licencim, deri në përfundimin e këtij procesi.	551	14.05.2026

13.	Vendim për pjesëmarrjen e pesë (5) zyrtarëve të KRU "Hidromorava"-SH.A, në forumin e Ujit të Danubit 2026 (DWF), me temën: "Nga vizioni në veprim -Ndërtimi I një Rajoni të Danubit Rezistent ndaj Ujit", I cili do të mbahet në Sofje, Bullgari nga data 20 deri më 22.maj.2026.	572/1	19.05.2026
14.	Vendimin për formimin e komisionit për pranim-dorëzim zyrtar të zyrës së Auditimit të Brendshëm me rastin e pranimit të detyrës së Auditorit të Brendshëm të kandidatit z.Betim Jashari.	574	19.05.2026
15.	Vendim për aprovimin e pushimit pa pagesë për punëtorin Kadrush Maloku, në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj e gjysmë, duke filluar nga data 15.06.2026 deri më 31.07.2026.	602	25.05.2026
16.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues sipas konkursit të brendshëm , nr.529 të dt 12.05.2026, për vlerësimin e kandidatëve në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese: Përgjegjës i autoparkut në KRU "Hidromorava"-SH.A.	633	29.05.2026
17.	Vendim për aprovimin e pushimit pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) muaji për të punësuarën R.A., duke filluar nga data: 08.06.2026 deri më: 07.07.2026.	640	02.06.2026
18.	Vendim për sistemimin e të punësuarit V.I., i sistemuar në detyrat punuese "Teknik i shkyçjes dhe kontrollit në Gjilan" në detyrat punuese "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave" nga data: 01.06.2026.	642	02.06.2026
19.	Vendim për formimin e një ekipi për identifikimin e kyçjeve ilegale për gjithë zonën e shërbimit në KRU "Hidromorava" Sh.A. për ndërmarrjen e masave të përditshme.	653	05.06.2026
20.	Vendim që i punësuarit Sh.G. i sistemuar në detyrat punuese "Ujëinstalues – Mjeshtër" në Nj.O. Kamenicë, të caktohet përkohësisht në detyrat punuese "Mjeshtër Kryesor" në KRU "Hidromorava" Sh.A. në Nj.O. Kamenicë, nga data: 01.06.2026 deri më: 30.11.2026.	655	05.06.2026
21.	Vendim nr. 749 i dt. 26.06.2026 për lejimin e qasjes në dokumente publike, sipas kërkesës së dt. 25.06.2026 të z. E.D. gazetar në Portalin Kallxo.Com.	749	26.06.2026
22.	Vendim për plotësim/ndryshimin e Vendimit nr. 59 të dt. 28.01.2026 lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të rjetit të kanalizimit.	753	30.06.2026

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ka mbajtur katër /4/ mbledhje të rregullta.

2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Të gjitha mbledhjet janë mbajtur me kuorum të plotë, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Punës së Bordit.

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e tretë të mbajtur me datë: 01.04.2026 ka marrë këto vendime:

1. Unanimisht është miratuar Procesverbali i Mbledhjes së dytë të Bordit të Drejtorëve i datës 27.02.2026.
2. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin shkurt 2026;
3. Unanimisht është miratuar "Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale në KRU "Hidromorava" Sh.A.";
4. Unanimisht është miratuar plotësim/ndryshimi i Shtojcës 1 të Rregullorja për pagat, kompensimet tjera dhe stimulimet e KRU "Hidromorava";
5. Unanimisht është miratuar Kërkesa nr. 356 të dt. 31.03.2026 e Shoqatës Sindikale të Pavarur të KRU "Hidromorava" - Sh.A. për ekzekutimin e pagës së trembëdhjetë (13-të) për punëtorët e KRU "Hidromorava" - Sh.A.;
6. Me shumicë votash është miratuar plotësim/ndryshimi i Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të punës sa i përket rikthimit së pozitës së Zëdhënës të Ndërmarrjes si dhe plotësim/ndryshimi i Rregullores për pagat sa i përket kësaj pozite;

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e katërt të mbajtur 29.04.2026 ka marrë këto vendime:

1. Unanimisht është miratuar Procesverbali i Mbledhjes së tretë të Bordit të Drejtorëve i datës 01.04.2026.
2. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin mars 2026.

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e pestë të mbajtur 29.05.2026 ka marrë këto vendime:

1. Unanimisht është miratuar Procesverbali i Mbledhjes së katërt të Bordit të Drejtorëve i datës 29.04.2026;
2. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës Tremujorin e Parë të vitit 2026 dhe Raportit mbi Menaxhimin e Rreziqeve për tremujorin e parë të vitit 2026;
3. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin prill 2026;
4. Unanimisht është miratuar Dokumenti për Vetëvlerësimin e Bordit të Drejtorëve për vitin 2025;
5. Unanimisht është miratuar Vendimi për autorizimin e Sekretares së Ndërmarrjes për udhëheqjen procesit të aplikimit për licencë shërbimi pranë ARRU-së;
6. Unanimisht është miratuar "Rregullorja për Procedurat e Rekrutimit në KRU "Hidromorava" Sh.A.".

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e gjashtë të mbajtur 19.06.2026 ka marrë këto vendime:

1. Unanimisht është miratuar Procesverbal i Mbledhjes së pestë të Bordit të Drejtorëve i datës 29.05.2026;
2. Unanimisht është miratuar Raporti i Punës për muajin maj 2026;
3. Unanimisht është miratuar Rishikimi i Planit të Biznesit për vitin 2026;
4. Unanimisht është miratuar "Rregullorja për Operimin, Monitorimin dhe Mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Shfrytëzimit të Ujit në KRU "Hidromorava" SH.A";
5. Me shumicë votash është miratuar propozimi nga Menaxhmenti për rritjen e vlerës së koeficientit me 0.25%, përkatësisht në vlerë monetare prej 60.00 €, për të gjithë të punësuarit, me efekt nga 1 korriku 2026;
6. Unanimisht është miratuar shfuqizimi i Vendimit nr. 1091/24 dhe Vendimi nr. 1090/24, të datës 27.08.2024, të nxjerra në zbatim të Opinionit të AKK-DPKI, me arsyetimin se, pas dorëheqjes së z. Arban Hoxha nga pozita e U.D. Drejtorit të Departamentit në Ministrinë e Bujqësisë, i është ndërprerë konflikti i interesit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ka mbajtur një / 1/ mbledhje të rregullt dhe bazuar në procesverbalin e datës: 15.05.2026, ka shqyrtuar dhe miratuar këto çështje:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., në Mbledhjen e katërt të mbajtur më 15.05.2026, ka shqyrtuar dhe miratuar çështjet në vijim:

1. Unanimisht është miratuar Procesverbalin nga Mbledhja e tretë e Komisionit të Auditimit e mbajtur me datë 27.02.2026;
2. Unanimisht është miratuar "Raporti i Auditimit të Jashtëm dhe Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me datë: 31.12.2025 me plotësimet dhe ndryshimet e kërkuara";
3. Unanimisht është miratuar "Deklarata për Politikën e Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU "Hidromorava" Sh.A. për vitin 2026";
4. Unanimisht është miratuar "emërimi i z. Betim Jashari në pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm në KRU Hidromorava Sh.A".
5. Është shqyrtuar Draft Raportit të tremujorit të parë të vitit 2026 dhe Draft Raporti i Menaxhimit të Rreziqeve.

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., në Mbledhjen e pestë të mbajtur më 15.06.2026, ka shqyrtuar dhe miratuar çështjet në vijim:

Unanimisht është miratuar Procesverbalin nga Mbledhja e katërt e Komisionit të Auditimit e mbajtur me datë 15.05.2026;

1. Është shqyrtuar Draft dokumenti i Rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2026 (me ndryshime dhe plotësime).

3.2. Përmbledhje e Raportit të Punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2026

Raporti i dorëzuar nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm (ZAB) për periudhën e tremujorit të dytë pasqyron rezultatet e arritura krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara për këtë periudhë dhe përfaqëson një raportim tërësor e gjithëpërfshirës mbi punën e realizuar.

- Auditimet e realizuara gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026

Draft Raporti i Auditimit – Sistemi i pagave dhe i mëditjeve.

4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, Zyra e Sekretares së Ndërmarrjes ka realizuar me përkushtim detyrat funksionale dhe ligjore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe menaxhmentin e lartë të Ndërmarrjes. Aktivitetet kryesore janë fokusuar në administrimin dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare, përgatitjen e materialeve për mbledhjet e organeve udhëheqëse, hartimin e raporteve periodike të punës dhe përgatitjen e akteve administrative në përputhje me komizën ligjore dhe rregulloret e brendshme të Ndërmarrjes. Në kuadër të përgjegjësiave institucionale janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

Përgatitja e procesverbaleve të mbledhjeve

Janë përgatitur procesverbalet për mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, përkatësisht:

Procesverbali i mbledhjes së katërt të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 29.04.2026;

Procesverbali i mbledhjes së pestë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 29.05.2026;

Procesverbali i mbledhjes së gjashtë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 19.06.2026;

Procesverbali i mbledhjes së katërt të Komisionit të Auditimit, mbajtur më 15.05.2026.

Përgatitja e raporteve periodike të punës

Janë hartuar dhe finalizuar dokumentet raportuese si në vijim:

Raporti i Punës për muajin mars, prill dhe maj 2026;

Raporti i Punës për tremujorin e parë (janar, shkurt dhe mars 2026);

Përgatitja e Draft Rregulloreve të brendshme

Në bashkëpunim me Zyrтарin e Burimeve Njerëzore janë përgatitur dhe finalizuar draft rregulloret si në vijim:

“Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale në KRU “Hidromorava” Sh.A.”;

“Rregullorja për Procedurat e Rekrutimit në KRU “Hidromorava” Sh.A.”.

Në bashkëpunim me Drejtorin Teknik dhe Menaxherin e Divizionit për Planifikim dhe Zhvillim të Projekteve është përgatitur draft rregullorja si në vijim:

“Rregullorja për Operimin, Monitorimin dhe Mirëmbajtjen e Infrastruktursë së Shfrytëzimit të Ujit në KRU “Hidromorava” Sh.A.”.

Përgatitja e vendimeve dhe dokumentacionit administrativ

Janë përgatitur të gjitha vendimet që janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit si dhe Menaxhmenti i Ndërmarrjes, duke u siguruar që të gjitha aktet administrative të jenë në përputhje me rregullat e brendshme dhe komizën ligjore në fuqi.

Aktivitetet lidhur me Vazhdimin e Lejeve Ujore dhe Rilicencimin e Ndërmarrjes

Gjatë muajit qershor 2026, me Vendim të Bordit të Drejtorëve, jam autorizuar që në emër të KRU Hidromorava Sh.A. të udhëheq procedurat për aplikimin për vazhdimin e lejeve ujore, si dhe procedurat e aplikimit për rilicencimin e KRU “Hidromorava” Sh.A., pranë institucioneve kompetente, në përputhje me autorizimin e dhënë nga Bordi i Drejtorëve.

Në kuadër të këtij autorizimi, në bashkëpunim me Menaxherin e Divizionit për Planifikim dhe Zhvillim të Projekteve kam udhëhequr dhe koordinuar procesin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, në bashkëpunim me divizionet dhe zyrtarët përgjegjës të Ndërmarrjes, me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore dhe afateve të përcaktuara për vazhdimin e lejeve ujore dhe rilicencimin e Ndërmarrjes.

4.1. Zyra e Burimeve Njerëzore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, Zyra e Burimeve Njerëzore ka menaxhuar dhe aprovuar pushimet e punëtorëve, si dhe ka shqyrtuar kërkesat e punëtorëve, si më poshtë:

- Janë nxjerrë tre (3) vendime për pushim pa pagesë.
- Janë vazhduar procedurat e konkursit të inicuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 dhe janë nxjerrë vendimet për rezultatet përfundimtare për pozitat: Punëtor i Pakualifikuar (2 pozita), Mjeshtër i Ujësjiellës (1 pozitë) dhe Mirëmbajtës i Pajisjeve Elektromekanike (1 pozitë) në Njësinë Operative të Kamenicës, si dhe për pozitën Përgjegjës i Autoparkut në kuadër të procedurës së konkursit të brendshëm.
- Është nxjerrë vendimi për sistemim të përhershëm për tre (3) punëtorë të Ndërmarrjes.
- Janë përpiluar tridhjetë (30) kontrata ose anekse të kontratave në përputhje me ndryshimet e koeficienteve, në bazë të Rregullores për Pagat, Kompensimet e Tjera dhe Stimulimet në KRU "Hidromorava" Sh.A.
- Janë përpiluar njëqind e shtatëdhjetë e tri (172) kontrata ose anekse të kontratave, konform Vendimit të Bordit të Drejtorëve për nritjen e pagave të punëtorëve të Ndërmarrjes.
- Është nxjerrë një (1) vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sipas fuqisë ligjore të dorëheqjes.
- Janë përpiluar tre (3) anekse të kontratave në përputhje me ndryshimet e koeficienteve, në bazë të plotësimit ndryshimit të Rregullores për Pagat, Kompensimet e Tjera dhe Stimulimet në KRU "Hidromorava" Sh.A.
- Janë nxjerrë katër (4) vendime për ndihmë solidare (ndihmë financiare) me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.
- Është realizuar auditimi i Zyrës së Burimeve Njerëzore nga Zyrtari i Lartë i Auditimit të Brendshëm.
- Janë aprovuar dhe janë ofruar dy (2) qasje në dokumente publike, në bazë të kërkesave të pranura.
- Janë nxjerrë njoftime për ditët e pushimit sipas Kalendarit të Festave Zyrtare për vitin 2026.
- Janë kthyer përgjigje në IQP lidhur me ankesat e dy (2) punëtorëve të Ndërmarrjes.
- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve, janë shqyrtuar njëzet e gjashtë (26) ankesa dhe u janë kthyer përgjigjet palëve ankuese.
- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor, është duke u zhvilluar procedurë disiplinore ndaj një (1) punëtori të Ndërmarrjes.

4.1.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, gjatë kësaj periudhe ka operuar me gjithsej 172 të punësuar.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM2/2026

Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese	Gjilan	Kamenicë	Viti
	134	19	19

Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM2/2026

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	Numri i të punësuarve (meshkuj)	Numri i të punësuarve (femra)
	147	25

4.1.2. Procedurat e rekrutimit dhe përmbyllja e konkurseve

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 nuk janë iniciuar apo zhvilluar procedura të reja të rekrutimit.

4.2. Zyra ligjore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjiilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Lëndët e pranura nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM2/2026

Lëndët e pranura nga gjykatat kompetente			
Datë	Institucioni	Nr. Aktvendimit/ Aktgjykimit	Arsyetimi
27.04.2026	Gjykata Themelore në Gjiilan	C.nr.1096/2025 e dt. 21.04.2026	Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr. 1096/2025, të datës 21.04.2026, kjo gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Tefik Poroshtica nga Gjilani kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A., me objekt kontesti padi për parashkrim dhe pasurim pa bazë, me vlerë të kontestit prej 858.00 €.
05.05.2026	Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë	C.A.nr.20188/2025 dt.03.04.2026	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 20188/2025, të datës 03.04.2026, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Xhevat Salihu nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit, ndërsa është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr. 744/2025, i datës 22.09.2025, me të cilin konsiderohet e tërhequr padia e paditësit Xhevat Salihu nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit, kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjiilan, me objekt kontesti padi kundër aktit administrativ.

26.05.2026	Gjykata Komerciale e Kosovës	K.DH.SH.II.nr.1339/25 dt.30.04.2026	Me Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 1339/25, të datës 30.04.2026, është aprovuar si i bazuar prapësimi i debitorit KRU "Hidromorava" Sh.A., duke u anuluar Urdhri Pëmbarimor P.nr. 207/24, i datës 15.05.2024, dhe duke përfunduar procedura në këtë çështje pëmbarimore, me ç'rast është konstatuar se është pëmbushur detyrimi monetar i debitorit KRU "Hidromorava" Sh.A. ndaj kreditorit K.N.T.SH. "Teuta" SHPK, në vlerë prej 100,000.00 €.
16.06.2026	Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë	C.A.nr.7590/2024 dt.07.05.2026	Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, C.A.nr. 7590/2024, të datës 07.05.2026, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Berat Dërmaku nga fshati Shipashnicë e Epërme, Komuna e Kamenicës, duke u vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr. 3376/2023, i datës 24.04.2024, lidhur me objektin e kontestit për anulimin e Vendimit nr. 2262, të datës 14.12.2023.

4.3. Arkivi

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, Zyra e Arkivit, nën përgjegjësinë e Zyrtares për Arkiv, ka realizuar menaxhimin dhe administrimin e dokumentacionit të ardhur dhe të dalë në përputhje me procedurat e brendshme të Ndërmanjes. Gjatë kësaj periudhe janë protokolluar dhe arkivuar gjithsej 572 akte nga shërbimi juridik.

Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e dokumenteve të protokolluara sipas departamenteve dhe njësive për muajin prill, maj dhe qershor, duke ofruar një pamje të qartë mbi volumet e punës dhe efikasitetin e procesit të arkivimit.

Tabela 6. Numri i dokumenteve administrative të protokolluara sipas njësive gjatë periudhës së TM2/2026

Nr.	Kategoria	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
1	Bordi i Drejtorëve	17	9	13	39
2	Kryeshefi Ekzekutiv	11	8	7	26
3	DR Teknik / Menaxher të projekteve	13	2	6	21
4	Zyra e Auditimit	3	4	1	8
5	ARRU	2	0	0	2
6	Zyra e Prokurimit	25	25	25	75

7	Menaxhmenti	2	5	0	7
8	ZBNj	21	35	185	241
9	Pëlqime	20	21	26	67
10	Komisione (Disiplinor/Vlerësues)	0	12	7	19
11	Ankesa/Kërkesa	9	10	16	35
12	Gjykata (Themelore/Apelit)	4	8	6	18
13	Të tjera	1	8	5	14
Totali		128	147	297	572

Tabela 7. Numri i dokumenteve (faturave) të protokolluara gjatë periudhës së TM2/2026

Nr.	Kategoria	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
1.	Protokolli i Financave	108	113	95	316

5. DEPARTAMENTI FINANCIAR

5.1. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, në Departamentin financiar janë realizuar aktivitetet:


- kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme;
- raportet ditore nga shërbimi i arkave;
- barazimi i gjendjeve bankare;
- kontimet;
- shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga institucionet mikro-financiare dhe bankare;
- kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre;
- përgatitjet e pagave;
- plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore;
- deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi;
- Identifikimi i pagesave që nuk janë shkarkuar te konsumatorët përkatës.

5.2. Shqyrtimi i performancës operative dhe financiare

5.2.1. Prodhimi i ujit në m³

Prodhimi i ujit në m³ për TM2/2026 në krahasim me TM2/2025 ka rritje për 3.64%, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar është tejkaluar për 5.17%.


Tabela 8. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m³



5.2.2. Faturimi i ujit në m³

Faturimi i ujit në m³ për TM2/ 2026 në krahasim me TM2/2025 ka shënuar rënie për 3.08%, ndërsa sa i përket caktit të planifikuar, është nën plan për 12.04%.


Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³



5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM2/2026 në krahasim me TM2/2025 ka rritje 32.57%, ndërsa sa i përket caktit të planifikuar, është nën plan për 7.51%.


Tabela 10. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)



5.2.4. Arkëtimi i ujit/€

Arkëtimi i ujit për TM2/2026 në krahasim me TM2/2025 ka shënuar rritje për 29.37 %, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është nën plan për 10.56%.


Tabela 11. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit/€



5.2.5 Përqindja e arkëtim

Përqindja e arkëtimit nga faturimi për TM2/2026 në krahasim me TM2/2025 ka shënuar ulje për 2.41%, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është nën plan për 3.30%.

Tabela 12. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit



5.2.5. Shpenzimet operative

Shpenzimet në TM2/2026 në krahasim me TM2/2025, kanë shënuar rritje për 22.16%. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të planifikuara janë për 16.10% më të ulëta se planifikimi.

Tabela 13. Paraqitja grafike e shpenzimeve në euro (€)




Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM2/2026 dhe TM2/2025 dhe plani TM2/2026

Indikatorët - Region	TM2/2026	TM2/2025	Realizimi 2026/2025	Trendi 2026/2025	Plani TM2 /2026	Realizimi i planit [%]	Trendi 2026 me Planin
1. Prodhim i ujit [m ³]	2,408,987	2,324,464	103.64	poz	2,290,500	105.17	poz
2. Faturimi [m ³]	1,037,547	1,070,536	96.92	neg	1,179,500	87.96	neg
3. Uji i pafaturar [m ³]	1,371,440	1,253,928	109.37	neg	1,111,000	123.44	neg
4. Faturimi [€]	933,326	704,017	132.57	poz	1,009,100	92.49	neg
5. Arkëtimi [€]	865,669	669,121	129.37	poz	967,850	89.44	neg
6. Shkalla e arkëtimit [%]	92.75	95.04	97.59	neg	95.91	96.70	neg
7. Shpenzimet operative [€]	655,862	536,871	122.16	neg	781,700	83.90	poz
8. Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	47,169	44,510	105.97	poz	47,892	98.49	neg
9. Numri i konsumatorëve me ujëmatës[nr]	42,935	40,403	106.27	poz	43,693	98.27	neg
10. Numri i konsumatorëve me konsum zero [nr]	21,839	18,810	116.10	neg	20,190	108.17	neg
11. Konsumatorë të rinj [nr]	368	476	77.31	neg	671	54.84	neg
12. Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	43,063	40,521	106.27	poz	43,783	98.36	neg
13. Numri i konsumatorëve pa matje [nr]	128	118	108.47	neg	200	64.00	poz
14. Faturimi i ujit me ujëmatës [m ³]	1,033,077	1,066,318	96.88	neg	1006981	102.59	poz
15. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës [%]	99.70%	99.71	99.99	poz	99.79	99.913	neg
16. UPF në [%]	56.93	53.94	105.53	neg	44.29	128.54	neg

17.	Norma e mbullimit operativ	1.32	1.25	106.21	poz	1.24	106.91	poz
18.	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	277,464	167,146	166.00	poz	227,400	122.02	poz
19.	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	209,807	132,250	158.64	poz	186,150	112.71	poz
20.	Kostoja për Njësi [€/m ³]	0.27	0.23	117.54	neg	0.34	79.55	poz
21.	Efikasiteti i stafit ['000 kons]	3.99	4.17	95.77	poz	3.93	101.67	neg

Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative të Gjilanit TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025

	Indikatorët – Gjilan	TM2/2026	TM2/2025	Realizimi 2026/2025	Trendi 2026/2025
1.	Prodhim i ujit (m ³)	1,684,716	1,676,570	100.49	poz
2.	Faturimi (m ³)	802,862	840,996	95.47	neg
3.	Uji i pafaturar (m ³)	881,854	835,574	105.54	neg
4.	Faturimi (€)	721,314	558,525	129.15	poz
5.	Arkëtimi (€)	697,636	554,018	125.92	poz
6.	Shkalla e arkëtimit (%)	96.72	99.19	97.50	neg
7.	Shpenzimet (€) ¹	511,084	421,731	121.19	neg
8.	Numri i konsumatorëve të regjistruar (total)	34,871	33,963	102.67	poz
9.	Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr.)	32,473	31,628	102.67	poz
10.	Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr.)	16,196	14,322	113.08	neg
11.	Konsumatorë të rinj (nr.)	296	328	90.24	neg
12.	Numri i konsumatorëve aktiv (nr.)	32,529	31,683	102.67	poz
13.	Numri i konsumatorëve pa matje (nr.)	56	55	101.82	neg
14.	Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	798,412	836,793	95.41	neg
15.	Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	99.83	99.83	100.00	-
16.	UPF në (%)	52.34	49.84	105.03	neg
17.	Norma e mbulimit operativ	1.37	1.31	103.91	poz
18.	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	210,230	136,794	153.68	poz
19.	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	186,552	132,287	141.02	poz
20.	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.30	0.25	120.60	neg
21.	Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.12	3.91	105.25	poz

¹ Rritje e shpenzimeve të energjisë në Nj.O. Gjilan, rritja e shpenzimeve të personelit për paga.

Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësine Operative të Kamenicës TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025

	Indikatorët – Kamenicë	TM2/2026	TM2/2025	Realizimi 2026/2025	Trendi 2026/2025
1.	Prodhimi i ujit (m ³)	339,124	236,454	143.42	poz
2.	Faturimi (m ³)	129,057	117,306	110.02	poz
3.	Uji i pafaturar (m ³)	210,067	119,148	176.31	neg
4.	Faturimi (€)	115,471	70,830	163.03	poz
5.	Arkëtimi (€)	99,336	62,336	159.36	poz
6.	Shkalla e arkëtimt (%)	86.03	88.01	97.75	neg
7.	Shpenzimet (€) ²	74,098	57,436	129.01	neg
8.	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	7,018	5,464	128.44	poz
9.	Numri i konsumtorëve me ujëmatës (nr)	5,852	4,328	135.21	poz
10.	Numri i konsumtorëve me konsum zero (nr)	2,968	2,135	139.02	neg
11.	Konsumatorë të rinj (nr)	55	20	275.00	poz
12.	Numri i konsumtorëve aktiv (nr)	5,852	4,328	135.21	poz
13.	Numri i konsumtorëve pa matje (nr)	0	0	-	-
14.	Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	129,057	117,306	110.02	poz
15.	Proportioni i konsumtorëve me ujëmatës (%)	100.00	100.00	100.00	-
16.	UPF në (%)	61.94	50.39	122.93	neg
17.	Norma e mbulimit operativ	1.34	1.09	123.52	poz
18.	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	41,373	13,394	308.89	poz
19.	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	25,238	4,900	515.05	poz
19.	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.22	0.24	89.95	poz
20.	Efikasiteti i stafit ('000 kons)	3.25	3.70	87.82	poz

² Rritja e shpenzimeve të energjisë dhe shpenzimet e pagave.

Tabela 17. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative në Vitisë për TM2/2026, krahasimi me TM2/2025

	Indikatorët - Viti	TM2/2026	TM2/2025	Realizimi 2026/2025	Trendi 2026/2025
1.	Prodhimi i ujit (m ³)	385,147	411,440	93.61	neg
2.	Faturimi (m ³)	105,628	112,234	94.11	neg
3.	Uji i pafaturar (m ³)	279,519	299,206	93.42	poz
4.	Faturimi (€)	96,541	74,662	129.30	poz
5.	Arkëtimi (€)	68,697	52,768	130.19	poz
6.	Shkalla e arkëtimit (%)	71.16	70.68	100.68	poz
7.	Shpenzimet (€) ³	70,680	57,704	122.49	neg
8.	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,280	5,083	103.88	poz
9.	Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr)	4,610	4,447	103.67	poz
10.	Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr)	2,675	2,353	113.68	neg
11.	Konsumatorë të rinj (nr)	17	128	13.28	neg
12.	Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	4,682	4,510	103.81	poz
13.	Numri i konsumatorëve pa matje (nr)	72	63	114.29	neg
14.	Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	104,001	110,663	93.98	neg
15.	Proportioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	98.46	98.60	99.86	neg
16.	UPF në (%)	72.57	72.72	99.80	poz
17.	Norma e mbulimit operativ	0.97	0.91	106.29	poz
18.	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	25,861	16,958	152.50	poz
19.	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	-1,983	-4,936	40.17	poz
20.	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.18	0.14	130.85	neg
21.	Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.06	4.43	91.51	poz

³ Rritja e shpenzimeve të energjisë dhe shpenzimet e pagave.

Tabela 18. Treguesit – shpenzimet operative për TM2/2026 dhe krahasimi me TM2/2025

Shpenzimet – Region	TM2/2026	TM2/2025	Realizimi 2026/2025
Shpenzimet e pagave (personeli)	443,300	381,025	62,275
Shpenzimet e energjisë	133,796	53,332	80,464
Shpenzimet për derivate	12,292	8,546	3,746
Shpenzimet për kemikate	3,410	11,291	-7,881
Shpenzimet për analiza të ujit	4,705	11,597	-6,892
Ngarkesa për shërbime të ARRU-së MMPH, SHUKOS	7,342	8,765	-1,423
Shpenzimet e qirasë	2,423	2,549	-126
Shpenzime për mirëmbajtje të automjeteve	10,022	6,049	3,973
Shpenzime për sigurime të automjeteve	3,303	4,430	-1,127
Shpenzimet për mirëmbajtje rrjetit ujë dhe kanalizim	3,348	3,613	-265
Shpenzimet e reprezentacionit/udhëtime zyrtare	11,505	5,199	6,306
Shpenzimet për telefon dhe internet	2,830	2,506	324
Shpenzimet e provizionit/përmbaruesit	964	991	-27
Shpenzimet e materialit administrativ	2,774	1,307	1,467
Shpenzime të tjera direkte	13,848	35,671	-21,823
Gjithsej	655,862	536,871	118,991

5.3. Draft pasqyrat financiare për TM2/2026

Draft Pasqyra e pozitës financiare 30 qershor 2026

	Shënimi	TM2 2026 (€)	TM2 2025 (€)
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1	743,080.00	1,034,198.00
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	2	3,175,230.00	3,178,886.00
Stoqet	3	735,315.00	491,493.00
Pasuritë e tjera afatshkurtra	4	763,962.00	101,234.00
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		5,417,587.00	4,805,811.00
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	43,380,264.00	46,845,731.00
Prona investuese		-	
Investimet në vijim	6	7,841,581.00	2,277,427.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		51,221,845.00	49,123,158.00
Gjithsej pasuritë		56,639,432.00	53,928,969.00

DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7	3,417,487.00	123,698.00
Tatimet e pagueshme aktuale		-	
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	8	147,426.00	129,873.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	9	3,564,913.00	253,571.00
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			-
Provizionet afatgjata			-

Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatgjatë			
Detyrimet për të hyrat e shtyera	10	8,862,480.00	6,813,118.00
Detyrimet e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		8,862,480.00	6,813,118.00
Gjithsej detyrimet		12,427,393.00	7,066,689.00

EKUITETI			
Kapitali aksionar	11	8,074,519.00	8,074,519.00
Fitimet/humbjet e bartura		-18,082.00	-93,857.00
Rezervat e rivlerësuar		36,155,602.00	38,881,618.00
Gjithsej ekuiteti		44,212,039.00	46,862,280.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		56,639,432.00	53,928,969.00

Draft Pasqyra e të ardhurave 30 qershor 2026

	Shënimi	TM2 2026 (€)	TM2 2025 (€)
TË HYRAT	13	914,202.00	697,484.00
Të hyrat e tjera		9,680.00	18,005.00
Të ardhurat tjera (grantet)		868,167.00	119,485.00
Total të hyrat		1,792,049.00	834,974.00
Shpenzimet e shpërndarjes (personelit)	15	-443,330.00	-381,025.00
Shpenzimet administrative (zhvlerësimi)		-976,768.00	-187,947.00
Shpenzimet energjisë elektrike		-133,796.00	-53,332.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes		-18,166.00	-32,983.00
Shpenzimet e kimikateve/derivateve /analiza		-19,903.00	-41,088.00
Total shpenzimet		-1,632,630.00	-743,491.00
Fitimi / (humbja) operative		159,419.00	91,483.00
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare	19	-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit	20	159,419.00	91,483.00
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e periudhës	21	159,419.00	91,483.00
Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse		-	-

Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			
Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse të periudhës		-	-
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithpërfshirëse të periudhës		-	-

Draft Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

	Kapitali Aksonar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Rezervat e rivlerësimit
Gjendja më 30 qershor 2025	25,000.00	(185,340.00)	8,049,519.00	38,881,618.00
		91,483		
Fitimi/(humbja) i/e periudhës	-	-	-	-
Dividentat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarje e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 30 qershor 2025	25,000.00	(93,857.00)	8,049,519.00	38,881,618.00
		(177,501.00)		
Gjendja më 30 qershor 2026				36,155,602.00
Fitimi humbja i/e vitit	-	159,419.00		
Dividevtat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarje e rezervave	-	-	-	-
Gjendja me 30 qershor 2026	25,000.00	-18,082.00	8,049,519.00	36,155,602.00

Draft Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Shënimi	TM2 2026 (€)	TM2 2025 (€)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi/(Humbja) i/e periudhës		159,419.00	91,483.00
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	22	976,768.00	187,948.00
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			-
Amortizimi i pasurive të paprekshme			-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			38,881,618.00
Të ardhurat financiare			-
Shpenzimet financiare			-
(Fitimi)/humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			-
Shpenzimet e tatimit në fitim			-
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		1,136,187.00	39,161,048.00
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	23	3,656.00	312,484.00
(Rritja)/zvogëlimi në stoke	24	-243,822.00	-56,846.00
(Rritja)/zvogëlimi në pasuritë e tjera	25	-662,728.00	3,177.00
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	26	3,293,789.00	-56,751.00
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera	27	17,553.00	11,503.00
Rritja/(zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	28	2,049,362.00	751,951.00
Tatimi në fitim i paguar			-
Interesi i paguar			-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		5,593,997.00	40,126,566.00
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	29	-	-327,653.00
Arkëtimet për shitjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve		5,564,154.00	
		-320,961.00	
			-39,482,373.00
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme			-
Interesi i arkëtuar			-
Dividentat e paguara			-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-5,885,115.0	-39,810,026.00
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			-
Dividentat e paguara			-

Arkëtimet nga kreditë dhe huatë			-
Ripagimi i kredive dhe huave			-
Pagesat e lizingut financiar			-
Rrjedha neto e parashë nga aktivitetet financuese			-
Rritje/(zvogëlim) neto i parashë dhe ekuivalentëve të parashë		-291,118.00	316,540.00
Paraja dhe ekuivalentët e parashë në fillim të periudhës		1,034,198.00	717,658.00
Paraja dhe ekuivalentët e parashë në fund të periudhës		743,080.00	1,034,198.00

Shënime shpjeguese 1. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

Tabela 19. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

	TM2/2026	TM2/2025
Llogaritë e arkëtueshme	7,786,742.00	7,981,946.00
Provizioni i llogarive – Amvisëri	3,632,815.00	3,776,263.00
Provizioni i llogarive – Biznes	826,681.00	411,196.00
Provizioni i llogarive – Institucione	7,538.00	463,585.00
Lejimet e bartura për shërbimet	144,478.00	152,016.00
Total provizioni	4,611,512.00	4,803,060.00
Neto të arkëtueshmet	3,175,230.00	3,178,886.00

Shënime shpjeguese 2. Stokset

Ndërmarrja përdor metodën e vlerësimit të stokeve sipas sistemit të vazhdueshëm. Regjistrimi bëhet në momentin e pranimit të e-mailit me metodën e pranimit të mallit, me metodën e së cilës përcaktohet kosto e stokeve sipas vlerës mesatare.

Tabela 20. Stokset

Përshkrimi - stokset	TM2/2026 Vlera në €	TM2/2025 Vlera në €
Depo Kamenicë	4,721.65	69,321.23
Depo Baja – kimikale	75.69	259.19
Depo e mbyllur Gjilan	263,478.05	225,189.43
Depo e hapur Gjilan	36,963.00	25,706.10
Depo administrative	2,157.22	1058.43
Depo materiale jo funksionale	32,229.40	546.73
Depo penda	575.29	37,414.09
Depo Përlepnicë – Gjilan	28,918.38	45,559.88

Depo Viti	62,715.38	66,846.81
Material depo Velekincë/Gjilan	3,060.44	7,653.31
Material revers	5,528.58	5,174.13
Depo punëtorja e ujëmatësve	6,673.67	6,763.67
Depo e hapur Kamenicë	28,628.30	0
Depo Kamenicë 1	61,510.00	0
Depo Kamenicë 2	3,137.95	0
Depo Donacion	192,842.52	0
Magazina e aseteve Gjilan (ende e pa përdorur)	2,099.48	0
Gjithsej	735,315.00	491,493.00

Shënimet shpjeguese 3. Pasuritë tjera afatshkurta

Tabela 21. Pasuritë tjera afatshkurta

	TM2/2026	TM2/2025
Tatimi në fitim	42,959.00	37,020.00
TVSH	647,472.00	107.00
Paradhënje	69,184.00	59,998.00
Parapagime	4,347.00	4,109.00
Gjithsej	763,962.00	101,234.00

Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet

Tabela 22. Pronat, impiantet dhe pajisjet

Emërtimi	TM2/2026	TM2/2025
Toka	5,270,695.00	5,270,695.00
Ndërtesa	14,281,557.00	14,933,532.00
Rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit, instalime teknike, makineri, pajisje	23,098,630.00	23,729,536.00
Mjete transporti	501,578.00	503,566.00
Mobile dhe pajisje zyre	131,514.00	2,299,437.00
Pajisje informative	96,290.00	108,965.00
Investime në vijim	7,841,581.00	2,277,427.00
Të tjera	0.00	0.00
Gjithsej	51,221,845.00	49,123,158.00

Shënimet shpjeguese 5. Investimet në vijim/projektet

- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit
- Projekti FLOWS – Faza e parë e tenderimit
- Projekti ITUN

- Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kyçjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE. - Gjilan
- Projekti FLOWS – Faza e dytë e tenderimit
- Ndërtimi i pusetave per MDA viti.
- Ndërrimi i gypave të ujesjellesit dhe instailimi kyqjeve te reja individuale Gjilan, Viti, Kamenicë sipas PMA-së 2026
- Ndërrimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në rrugën Abdullah Tahiri me gjatësi L=450 m- ri tender
- Izolimi i objektit të administratës Viti

Shënimet shpjeguese 6. Llogaritë e pagueshme për TM2/2026

Tabela 23. Llogaritë e pagueshme

Emertimi i Furnitorit	Detyrimi
ALB STAR Sh.P.K. Dega në Kosovë ⁴	2,973,486.83
"Teuta-M" Sh.P.K. ⁵	146,690.20
"KEK" Sh.A.	137,328.05
"XERXA HIDRO GROUP" Sh.P.K. ⁶	44,929.20
"Seykos" Sh.P.K. ⁷	15,288.00
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	11,462.17
"NanoLAB" SH.P.K. ⁸	9,670.00
"Interlab" Sh.P.K. ⁹	7,430.00
"Rizah Avdiu" B.I. (Baron) ¹⁰	6,235.00
"HITERM EL" ¹¹	5,076.56
"HIB PETROL" Sh.P.K. ¹²	9,459.87
SHUKOS	3,230.00
Komuna e Gjilanit Tatimi në Pronë	2,530.28
Telekomi i Kosovës SH.A.	3,042.95
"Hidro Project" ¹³	1,962.32

⁴ Projekti i Impiantit nuk përbën obligim të KRU Hidromorava Sh.A., pasi që financohet nga Qeveria e Kosovës dhe ne jemi vetëm përfitues të këtij projekti. Megjithatë, ai është evidentuar në evidencat kontabël të ndërmarrjes, për shkak se mjetet financiare transferohen fillimisht nga Qeveria e Kosovës në llogarinë e KRU Hidromorava Sh.A., e më pas nga ne transferohen te operatori përkatës.

⁵ Projekte kapitale të ndryshme për ndërrimin e gypave.

⁶ Furnizim me pjesë fazonike.

⁷ Kimikate (Hipoklorit klor i gazët, permanganat).

⁸ Furnizim me elemente për laborator.

⁹ Furnizim me pjesë dhe kimikate për testimin e ujit në laborator.

¹⁰ Izollimi i objektit në Nj.O. në Viti.

¹¹ Pompa zhytëse për FPU-të.

¹² Shpenzime të derivateve.

¹³ Pjesë fazonike.

"AUTOBALLKAN GROUP" ¹⁴	1,954.00
"Hotel Alfonso" ¹⁵	1,853.28
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik - Taksa Komunale	1,800.00
"NOOTEX" Sh.P.K. ¹⁶	1,784.90
D.T.P. "EDONI" (Afrim Canaj B.I.) ¹⁷	1,678.70
"UNIVERSAL" Sh.P.K. ¹⁸	1,430.00
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - Gjilan	1,250.00
Instituti Regjional i Shëndetësisë Publike Gjilan	1,167.39
Instituti Kombëtar Shëndetësisë Publike Prishtinë	1,090.00
"Resort PLANET Eco" Sh.P.K.	1,070.14
Furnitorë nën 1,000 €	24,587.16
Gjithsej	3,417,487.00

Shënime shpjeguese 7. Detyrimet tjera afatshkurtra

	TM2 2026	TM2 2025
Parapagime të marra	105,463.00	96,027.00
Kontribute pensionale	14,110.00	11,235.00
Detyrime të tjera	163.00	425.00
Detyrime ndaj sindikatës ¹⁹	19,212.00	14,341.00
Tatime mbi të ardhurat	8,478.00	7,845.00
Gjithsej	147,426.00	129,873.00

Tabela 24. Detyrimet tjera afatshkurtra

Përshkrimi	TM2/2026	TM2/2025
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	3,417,487.00	123,698.00
Detyrimet tjera afatshkurta	147,426.00	129,873.00
Gjithsej	3,564,913.00	253,571.00

¹⁴ Mirëmbajtje e automjeteve të rënda.

¹⁵ Shpenzimet e Hotelit për Konferencën në Zaragoza, Spanjë.

¹⁶ Material administrativ (fatura të konsumatorëve).

¹⁷ Furnizim me mjete pune dhe pjesë fazonike për Nj.O Kamenicë.

¹⁸ Mirëmbajtje e automjeteve nën 3.5 ton.

¹⁹ Ky obligim i përket Sindikatës së Hidromoravës, ku ne, si Ndërmarrje u ndalim kontributin punëtorëve që janë të regjistruar në sindikatë dhe më pas e transferojmë atë në llogarinë e sindikatës.

Shënimet shpjeguese 8. Të hyrat e shtyra/grantet

Tabela 25. Të hyrat e shtyra /grantet

Përshkrimi	TM2/2026	TM2/2025
Të hyrat e shtyra në fillim të vitit	6,359,257.00	6,774,818.00
Të hyrat e shtyra me 30 qershor	8,862,480.00	6,813,118.00

Shënimet shpjeguese 9. Ndryshimi në ekuitet

Tabela 26. Ekuiteti

	TM2/2026	TM2/2025
Ekuiteti me 30 qershor 2026	44,212,039.00	46,845,731.00
Gjithsej	44,212,039.00	46,845,731.00

Shënimet shpjeguese 10. Të hyrat

Tabela 27. Të hyrat

	TM2/2026	TM2/2025
Të hyrat nga shitja e ujit	914,202.00	697,484.00
Të hyrat nga shërbimet	9,680.00	18,005.00
Të hyrat nga grantet	868,167.00	119,485.00
Të hyrat totale	1,792,049.00	834,974.00

Shënimet shpjeguese 11. Shpenzimet e shpërndarjes

Tabela 28. Shpenzimet e shpërndarjes

	TM2/2026	TM2/2025
Shpenzimet e personelit	(443,330.00)	(381,025.00)

Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet administrative të tjera

Tabela 29. Shpenzime administrative të tjera

	TM2/2026	TM2/2025
Shpenzimet administrative (zhvlerësimi)	(976,768.00)	(187,947.00)
Shpenzimet energjisë elektrike	(133,796.00)	(53,332.00)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	(18,166.00)	(32,983.00)
Shpenzimet e kimikateve/derivate/analiza të ujit	(19,903.00)	(41,088.00)
Shpenzimet e tjera operative	(40,667.00)	(47,116.00)
Total shpenzimet	(1,189,300.00)	(743,491.00)

Shënimet shpjeguese 13. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit

Tabela 30. Fitimi (humbja) para tatimit

30 qershor 2026	159,419.00€
30. qershor 2025	91,483.00€

Shpalosja e ndryshimeve në ekuitet

Tabela 31. Ndryshimet në ekuitet

Kapitali aksionar	8,074,519.00
Fitimi i vitit paraprak	-90,755.00
Fitimi/humbjet e bartura	-90,755.00
Fitimi/humbja e vitit aktual	159,419.00
Fitimi/humbjet e bartura	0.00

Pagesat e pa identifikuara

Tabela 31. Pagesat e pa identifikuara në fillim të periudhes dhe në fund

Pagesat e pa identifikuara me 30.04.2026	46,243
Pagesat e pa identifikuara me 31.07.2026	46,001

6. ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ka pranuar pesëmbëdhjetë kërkesa me shkrim, për furnizime, shërbime dhe punë, nga njësitë përkatëse të cilat janë iniciuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, ku këto kërkesa pastaj janë proceduar varësisht prej prioriteteve dhe konform rregullave të prokurimit.

Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – vlerë minimale

Data:	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
09.06.2026	Furnizim me pjesë të ndryshme fazonike	"X" Sh.P.K.	930.00€

Tabela 33. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – "kuotim i çmimit"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
17.04.2026	Izolimi i objektit të administratës në Viti	"Rizah Avdiu" B.I.	6,235.00 €
07.05.2026.	Furnizim me rërë të kuarcit për filtra	"Omega - I" SH.P.K	4.000,00 €
06.05.2026	Furnizim me goma për automjetet e KRU "Hidromorava"	"Tafa - S" SH.P.K.	5.492,00 €
18.05.2026	Furnizim me reagjentë Kimik	"NanoLAB" SH.P.K.	9.670,00 €
12.06.2026	Furnizim me material shpenzues për nevojat e KRU "Hidromorava" Sh.A.	"Olti & Kenza" Sh.P.K.	5,100.00€

Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – "procedurë e hapur – vlerë e mesme"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
03.04.2026.	Ndërimi i gypave të ujësllësit dhe instalimi i kyçjeve të reja individuale: Gjilan, Viti dhe Kamenicë sipas PMA-së.	Grupi i Operatorëve Ekonomik: K.N.T.SH. "Teuta - M" Sh.P.K. "Infra - Plus" Sh.P.K.	339,549.77€
15.06.2026	Furnizim me ekskavator – Ritenderim	"Ortu" Sh.P.K.	104,914.00€

Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM2/2026 – "procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës – vlerë e mesme"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
30.04.2026	Mirëmbajtja e sistemit të Software'it të faturimit dhe kontabilitetit si dhe çështjeve tjera që lidhen me Software	"IMB Soft" Sh.P.K.	29,160.00 €

7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT

7.1. Cilësia e ujit

Raporti i tremujorit të dytë të vitit 2026 jep një pasqyrë të përmblodhur të cilësisë së ujit të pijshëm nëpër të gjitha zonat e KRU "Hidromorava" Sh.A.

Bazuar në rezultatet e analizave fiziko – kimike dhe mikrobiologjike të punura në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjiilan – QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHPK, cilësia e ujit gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ka qenë rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujin e pijshëm.

Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpërmjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.

1. **Zona HM 01** – burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liçeni i Përlepnicës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
2. **Zona HM 02** – burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
3. **Zona HM 03** – burimi "Baja";
4. **Zona HM 04** – zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovçë dhe Bilinice);
5. **Zona HM 05** – Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
6. **Zona HM 06** – burimet e ujit në fshatin Pozharan;
7. **Zona HM 07** – burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaçevë dhe Shipashnicë;
8. **Zona HM 08** – burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
9. **Zona HM 09** – burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
10. **Zona HM 10** – burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Parametrat të cilat kontrollohen për ta vërtetuar cilësinë e ujit janë:

- **Parametrat fizik të cilët janë punuar janë:** era, ngjyra, shija, përçueshmëria elektrike, turbullira fortësia e ujit.
- **Parametrat kimik të cilët janë punuar:** pH, klori residual, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i KMnO_4 , fosfatet, kloruret, alumini.
- **Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar:** numri i tërësishëm i baktereve koliforme në 100 ml, bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml, numri i tërësishëm i baktereve të gjalla në 1 ml në 37 gradë celsius, streptokoket me prejardhje fekale në 100ml.

Në baza tre mujore punohen edhe metalet e rënda, trehalometanet THM, si dhe karboni total organik TOC. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, cilësia e ujit të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU "Hidromorava" Sh.A. ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi. Shumica e burimeve ujore, impianteve të trajtimit dhe stacioneve të pompimit kanë furnizuar konsumatorët me ujë që ka plotësuar parametrat fizik, kimik dhe mikrobiologjik të përcaktuar me aktet ligjore në fuqi. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar disa devijime të përkohshme, të cilat kanë qenë kryesisht pasojë e kushteve të pafavorshme hidrologjike dhe problemeve operative në procesin e dezinfektimit. Për secilin rast janë ndërmarrë masa korrigjuese të menjëhershme dhe është intensifikuar monitorimi laboratorik deri në stabilizimin e plotë të situatës.

Muaji prill 2026

Gjatë muajit prill, situata e cilësisë së ujit ka qenë përgjithësisht stabile. Përfashtim ka qenë Impianti i Trajtimit të Ujit (ITU) në Letnicë – Viti, ku më 03.04.2026, si pasojë e rritjes së turbullirës në ujin e papërpunuar pas reshjeve intensive, është ndërprerë përkohësisht procesi i prodhimit të ujit deri në stabilizimin e parametrave të cilësisë. Pas normalizimit të turbullirës dhe konfirmimit të rezultateve përmes analizave laboratorike, procesi i trajtimit dhe furnizimi me ujë janë rikthyer në funksionim normal, pa u evidentuar probleme të tjera gjatë muajit.

Situata e Nitrave ne Rajonin e Kamenicës.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 ka vazhduar monitorimi intensiv i përqendrimit të nitrave në rajonin e Kamenicës. Rritja e përqendrimit të nitrave është lidhur me reshjet intensive dhe vërshimet e ndodhura në muajt paraprakë, të cilat kanë ndikuar në infiltrimin e ujërave sipërfaqësore në akuiferët e cekët pranë lumit Kriva Reka. Problematika është evidentuar kryesisht në:

- Stacionin e Pompimit Nr. 2 në Kamenicë, i cili furnizohet nga tre burime (dy burime në lokalitetin Bashqja dhe një burim pranë stacionit);
- Zonën e Berivojcës.

Në burimet Bashqja 1, Bashqja 2 dhe burimin pranë SP Nr. 2 në Kamenicë është evidentuar ulje graduale e përqendrimit të nitrave, duke treguar një trend të vazhdueshëm përmirësimi, megjithëse ende regjistrohen tejkallime të lehta të vlerave parametrike.

Ndërkohë, në Stacionin e Pompimit Berivojcë vazhdojnë të regjistrohen përqendrime më të larta të nitrave krahasuar me lokalitetet e tjera, duke e bërë këtë zonë më të ndjeshmen nga aspekti i cilësisë së ujit. Megjithatë, gjatë tremujorit nuk është evidentuar përkeqësim i mëtejshëm i situatës.

Aktualisht nuk janë të mundshme ndërhyrje teknike në pusët ekzistuese, pasi ato janë të ndërtuara dhe të izoluar. Bazuar në vlerësimet profesionale, rritja e nitrave konsiderohet pasojë e infiltrimit të ujërave gjatë përmbytjeve dhe transportit të materialeve nga zonat bujqësore ku përdoren plehra kimike.

Muaji maj 2026

Gjatë muajit maj, cilësia e ujit të pijshëm ka qenë përgjithësisht e mirë dhe në përputhje me kërkesat ligjore në shumicën e burimeve, impianteve të trajtimit dhe stacioneve të pompimit.

Edhe gjatë këtij muaji, në SP Berivojcë dhe SP Nr. 2 në Kamenicë kanë vazhduar të evidentohen përqendrime të nitrave mbi kufijtë parametrikë të lejuar. Për këto sisteme është vazhduar monitorimi i rregullt laboratorik dhe përcjellja e vazhdueshme e trendeve, me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme për stabilizimin e situatës.

Muaji qershor 2026

Gjatë muajit qershor, cilësia e ujit të pijshëm ka qenë përgjithësisht në nivel të kënaqshëm, me përputhje të parametrave fizikë dhe kimikë në shumicën e sistemeve të furnizimit.

Megjithatë, në disa stacione të pompimit është evidentuar mungesë ose sasi minimale e klorit rezidual, si pasojë e mungesës së hipokloritit të natriumit në disa pika të sistemit. Si rezultat, në mostrat e ujit të marra nga rrjeti i furnizimit në fshatrat Zhegër, Dobërqan, Ranillug dhe Ropotovë janë evidentuar tejkallime të parametrave mikrobiologjikë.

Pas identifikimit të situatës janë ndërmarrë menjëherë masa korrigjuese, duke furnizuar stacionet me sasinë e nevojshme të hipokloritit të natriumit, rritur dozimin e dezinfektimit dhe intensifikuar monitorimin laboratorik. Si rezultat i këtyre masave, është rikthyer niveli i kërkuar i klorit rezidual.

Sa i përket parametrave kimik, situata mbetet e pandryshuar në SP Berivojcë dhe SP Nr. 2 në Kamenicë, ku vazhdon të evidentohet prania e nitrave mbi vlerat parametrike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Për këto sisteme vazhdon monitorimi i rregullt dhe zbatimi i masave operative të planifikuara.

Përfundim

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, cilësia e ujit të pijshëm në përgjithësi ka qenë në nivel të kënaqshëm dhe në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi. Devijimet e evidentuara kanë qenë të kufizuara në disa sisteme specifike dhe kanë qenë kryesisht pasojë e kushteve të pafavorshme hidrologjike dhe problemeve të përkohshme operative në procesin e dezinfektimit.

Të gjitha rastet janë trajtuar me masa korrigjuese të menjëhershme, ndërsa monitorimi laboratorik është intensifikuar deri në rikthimin e parametrave brenda kufijve të lejuar. Për zonat me përqendrim të rritura të nitrave, veçanërisht SP Berivojcë dhe SP Nr. 2 në Kamenicë, do të vazhdojë monitorimi i vazhdueshëm, analiza e trendeve dhe zbatimi i masave afatshkurtra dhe afatgjata për përmirësimin e cilësisë së ujit dhe garantimin e furnizimit të sigurt për konsumatorët.

8. DEPARTAMENTI TEKNIK

8.1 Aktivitetet kryesore të drejtorit teknik

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, janë realizuar këto aktivitete:

Përgatitja e raporteve mujore dhe TM2 2026

Janë mbledhur raportet nga divizionet teknike, nga Koordinatorja e UPF-së dhe menaxherët e njësive operative, të cilat janë përmbledhur në një raport të vetëm.

Aktivitetet ditore operative

Janë mbajtur takime ditore (briefing) me menaxherët e divizioneve, me fokus në evitimin e defekteve dhe koordinimin e aktiviteteve operative.

Takimet javore me menaxherët e divizioneve teknike

Gjatë këtyre takimeve janë shqyrtuar defektet e paraqitura në rrjet gjatë javës, janë caktuar detyrat dhe afatet për realizimin e punimeve në terren, si dhe janë diskutuar çështje të tjera operative.

Është diskutuar statusi i projekteve në implementim, i projekteve që janë në proces të tenderimit, si dhe i projekteve për të cilat është duke u përgatitur paramasa dhe parallogaria. Gjithashtu, janë trajtuar problemet në impiantet e trajtimit të ujit dhe në stacionet e pompimit, duke u caktuar detyra konkrete për evitimin e tyre.

Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projektet e Ministrisë së Ekonomisë (ME)

Në bashkëpunim me Divizionin për Planifikim dhe Zhvillim të Projekteve dhe Divizionin e Rrjetit të Ujësjetës, janë përgatitur paramasat dhe parallogaritë për projektet e kërkuara nga Ministria e Ekonomisë, për të cilat pritet konfirmimi i investimit të tyre.

Përcjellja e furnizimit me ujë të konsumatorëve në Lagjen e Zabelit

Në bashkëpunim me Menaxherin e Rrjetit të Ujësjetës, është përcjellë shtypja në rrjetin e ujësjetës për konsumatorët në Lagjen e Zabelit (në pikat e larta), pasi këta konsumatorë nuk furnizohen me ujë 24 orë dhe kanë paraqitur ankesë në ARRU.

Vizitat në terren te konsumatorët që ankohen për mungesë të ujit

Në bashkëpunim me Menaxherin e Rrjetit të Ujësjetës, janë realizuar vizita në terren te konsumatorët që kanë paraqitur ankesa për mungesë të furnizimit me ujë, me qëllim të identifikimit të shkaktarëve dhe gjetjes së zgjidhjeve për përmirësimin e furnizimit në këto zona.

Gjatë vizitave është bërë vlerësimi i gjendjes së rrjetit dhe janë diskutuar masat e nevojshme për normalizimin e furnizimit me ujë.

Takimi me operatorin e ARRU-së për të dhënat që duhet të futen në SISHU (Sistemi Informativ i Shërbimeve të Ujit)

Në bashkëpunim me Koordinatorin e UPF-së, është mbajtur takim me përfaqësuesit e ARRU-së, ku është diskutuar lidhur me saktësinë e informatave që duhet të futen në SISHU, si dhe problemet që po paraqiten në sistem, siç është rasti i humbjes së të dhënave.

Takim me ARRU-në për ritjen e UPF-së në Kamenicë

Në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv, është mbajtur takim me Zëvendës drejtorin e ARRU-së, në të cilin janë diskutuar çështjet lidhur me ritjen e Ujit të Pa Faturuar (UPF) në Komunën e Kamenicës, si dhe problematikat e hasura gjatë procesit të futjes së të dhënave në Sistemin Informativ të Sektorit të Ujit (SISHU).

Takimi ka pasur për qëllim adresimin e sfidave aktuale dhe koordinimin e veprimeve institucionale për përmirësimin e saktësisë së të dhënave dhe uljen e nivelit të UPF-së.

Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit

Në bashkëpunim me Menaxherin e Divizionit për Planifikim dhe Zhvillim të Projekteve, është mbajtur takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit, me qëllim të koordinimit të projekteve që implementohen nga Komuna dhe nga KRU "Hidromorava" Sh.A.

Takimi ka pasur për qëllim harmonizimin e aktiviteteve dhe sigurimin e një qasjeje të koordinuar në realizimin e projekteve infrastrukturore, me fokus në parandalimin e duplikimit të projekteve dhe ritjen e efikasitetit në implementim.

Punëtorja e organizuar nga MMPHI, datë 14 maj 2026

Është marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga MMPHI, përmes ARPL-së, e mbështetur nga Programi për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM).

Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë prezantimi i gjetjeve kryesore nga vlerësimi i presioneve mjedisore, si dhe diskutimi i problemeve kryesore që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore të pellgut. Gjetjet dhe çështjet e trajtuara janë përmbledhur në raportin e përkohshëm për konsultim publik me titull: "Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Kosovë".

Takimet me konsumatorë

Janë realizuar takime me konsumatorë të cilët kanë paraqitur ankesa të ndryshme, si mungesë të ujit, zvogëlim të shtypjes, kërkesa për kycje të re etj. Në shumë raste, konsumatorët janë vizituar edhe në terren, me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve sa më të shpejta dhe efikase.

Vlen të theksohet se, në krahasim me vitin e kaluar, ankesat për mungesë të ujit janë më të pakta, pasi sasi të ujit në burime janë më të mira këtë vit dhe ekipet tona janë vazhdimisht në terren.

8.2. Divizioni për prodhimin e ujit dhe stacionet e pompimit

8.2.1 Furnizimi me ujë dhe defektet e paraqitura

Niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnicës gjatë tre muajve të fundit ka qenë në kuotën maksimale. Gjatë kësaj periudhe, edhe në burimet e tjera në Gjilan, si "Baja", "Guri i Hoxhës" dhe pusët në Velekincë, për shkak të reshjeve të dendura, kapaciteti i prurjeve ka qenë në nivel maksimal.

Si rezultat i këtyre reshjeve, furnizimi me ujë të pijshëm gjatë kësaj periudhe ka qenë i qëndrueshëm dhe i kënaqshëm. Sa i përket funksionimit të stacioneve të pompimit, në rajonin e Gjilanit situata ka qenë stabile, ndërsa problemet e paraqitura kanë qenë kryesisht të natyrës së komunikimit ndërmjet stacioneve të pompimit dhe rezervuarëve, të cilat janë eliminuar në kohë.

Ndërkaq, në komunën e Kamenicës, si zakonisht, janë paraqitur disa probleme në funksionimin e elektropompave, të cilat janë evituar me prioritet.

8.2.2. Implementimi i projektit FLOWS

Punimet në kuadër të projektit FLOWS janë duke u zhvilluar sipas planit dhe deri më tani nuk janë evidentuar probleme të theksuara që do të mund të ndikojnë në ndërprerjen e tyre.

8.2.3. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit

Sasia e ujit të prodhuar në nivel të komunave nuk ka qenë plotësisht stabile, për shkak të problemeve të paraqitura në sisteme. Në Përlepnice janë evidentuar probleme me ujëmatësin e prodhimit të ujit të papërpunuar, i cili është riparuar me kohë, duke e kthyer procesin e prodhimit në normalitet.

Siç është theksuar edhe në raportet paraprake, në Divizionin e Prodhimit vazhdimisht është realizuar koordinim me Drejtorinë Teknike dhe Menaxherin e Rrjetit të Ujësjetës lidhur me sasinë e ujit të prodhuar, me qëllim që raporti ndërmjet prodhimit dhe konsumit të jetë i balancuar. Kjo qasje ka për synim sigurimin e furnizimit optimal për konsumatorët, duke shmangur njëkohësisht prodhimin e tepërt të ujit që mund të ndikojë negativisht në rrjetin e ujësjetës.

Prodhimi i ujit sipas nevojës (jo në kapacitet maksimal, siç ka qenë praktikë më herët), përveç që siguron furnizim të pandërprerë, kontribuon edhe në rritjen e sigurisë së rrjetit, si dhe në uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Periudha e tremujorit të dytë është karakterizuar me disa probleme teknike, kryesisht defekte në pompa dhe në sistemin e komandimit ndërmjet rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit. Problemet më të theksuara kanë qenë me ujëmatësin në "Guri i Hoxhës", si dhe me ujëmatësin që mat sasinë e ujit të përpunuar nga stacioni i pompimit në impiantin e Përlepnices.

Sa i përket ujëmatësit të ujit të papërpunuar, është përgatitur paramasa dhe është zhvilluar procedura e tenderimit. Megjithatë, për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë, procesi i prokurimit është zgjatur. Si zgjidhje e përkohshme, janë marrë pjesë nga Letnica për funksionalizimin e ujëmatësit të prodhimit të ujit të papërpunuar, nga liqeni deri te penda.

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë janë tenderuar dhe përfunduar disa projekte, përfshirë matjet e tokëzimit dhe rufepitësve, rregullimin e ndarësit të tensionit 10 kV dhe vendosjen e rufepitësit në një pjesë të impiantit në Përlepnice. Po ashtu, është realizuar furnizimi dhe instalimi i aktuatorëve në impiantin në Velekincë, duke mundësuar operimin automatik të procesit të pastrimit të filtrave.

Sasia e ujit të prodhuar dhe të faturuar, si dhe uji i pafaturuar (UPF) gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, për secilën komunë veçmas, është paraqitur në tabelën pasuese.

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2026 për komuna

	Prodhimi TM2/2026 (m³)	Faturimi TM2/2026 (m³)	UPF TM2/2026 (%)	Prodhimi TM2/2025 (m³)	Faturimi TM2/2025 (m³)	UPF TM2/2025 (%)
--	------------------------------	------------------------------	------------------------	------------------------------	------------------------------	---------------------

Gjilan	1,654,263	788,047	52.36	1,629,407	825,974	49.3
Partesh	6,424	587	90.86	14,487	1,231	91.5
Viti	385,147	105,629	72.57	411,440	112,234	72.7
Kamenicë	339,124	129,057	61.94	236,454	117,308	50.4
Ranillug	20,936	10,732	48.7	18,226	11,057	39.3
Novobërdë	3,093	3,487	-12.74	14,459	2,714	81.2

Tabela 37. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2026

Burimi	Prodhimi TM2-2026	Faturimi TM2-2026	UPF [%] TM2 2026	Prodhimi TM2-2025	Faturimi TM2-2025	UPF (%) TM2- 2025	Trendi
ITU Përlepnicë dhe Guri i Hoxhës	1,055,930	749,500	51.87	1,038,249	788,915	48.3	Negativ
FPU Velekincë	311,930			343,098			
Baja*10	189,503			144,190			
Pasjan (komulative)	6,424	587	90.86	14,487	1,231	91.5	Pozitiv
Malisheva e Ulët	12,813	4,923	61.58	15,569	3,251	79.1	Pozitiv
Llovçë	1,000	753	24.7	845	755	8.3	Negativ
Dobërçan*10	21,833	6,191	71.64	27,403	8,591	68.6	Negativ
Zhegër*10	60,130	26,132	56.54	58,165	23,683	59.3	Pozitiv
Bilinicë	1,124	548	51.25	1,888	779	58.7	Pozitiv
ITU Letnicë - Viti	271,190	68,210	74.85	281,920	78,405	72.2	Negativ
Tërstenik	34,147	7,550	77.89	55,060	8,559	84.5	Pozitiv
Pozhoran	73,450	28,056	61.80	67,660	23,636	65.1	Pozitiv
Ujesjellesi Letnicë	6,360	1,813	71.49	6,800	1,634	76	Pozitiv
Stacioni i pompimit nr. 1, Kamenicë	37,670	69,884	61.0	46,150	76,365	48.1	Negativ
Stacioni i pompimit nr. 2, Kamenicë	72,583			31,745			
Stacioni i pompimit nr. 3, Kamenicë	7,347			11,774			
Stacioni i pompimit nr. 4, Kamenicë	25,398			34,138			
Stacioni i pompimit nr. 5 Kamenicë	4,650			4,740			

Stacioni i pompimit nr. 6 Kamenicë	31,559			18,532			
Topanicë	18,780	12,413	33.9	16,795	13,731	18.2	Negativ
Kopërmicë & Kolloleq	21,290	5,123	75.94	7,720	6,374	17.4	Negativ
Koretin	24,100	11,976	50.31	26,626	10,900	59.1	Pozitiv
Shipashnicë e Epërme	27,561	4,161	84.90	28,580	6,141	78.5	Negativ
Karaçevë	9,146	3,807	58.38	9,654	3,797	60.7	Pozitiv
Gjashtë fshatrat në Kamenicë	59,040	21,693	63.26				
Ranillug	17,820	8,059	54.78	15,110	7,695	49.1	Negativ
Ropotovë	3,116	2,673	14.22	3,116	3,362	-7.9	negativ
Boston, Qulkoc, Makresh	3,093	3,487	-12.74	14,459	2,714	81.2	Pozitiv
Prodhimi total m³/TM2	2,408,987	1,037,539	56.93	2,324,134	1,070,538	53.9	Negativ

Konkluzion – UPF dhe faturimi – TM2 2026

Rritja e prodhimit të ujit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 vjen si rezultat i disa faktorëve kryesorë:

Duke filluar nga muaji nëntor 2025, është marrë në menaxhim sistemi i ujësjellësit për gjashtë fshatra të Komunës së Kamenicës (Hodonoc, Shipashnicë e Poshtme, Roganë, Muçivercë, Dajkovc dhe Novosellë), çka ka reflektuar në një rritje të prodhimit në TM2 2026 prej 59,040 m³.

- Nga muaji maj 2025 është vënë në funksion sistemi i pompimit nr. 6 në Kamenicë (Berivojcë), me një prodhim shtesë prej 31,559 m³.
- Me ndërtimin e rezervuarit të ri, stacioni i pompimit nr. 2 në Kamenicë ka shënuar rritje të prodhimit prej 40,838 m³. Megjithatë, kjo rritje e prodhimit nuk është reflektuar edhe në rritjen e faturimit, gjë që paraqet shqetësim për kompaninë. Në bashkëpunim me Koordinatorin e UPF-së është realizuar vizitë në Njësinë e Kamenicës me qëllim të identifikimit të shkaqeve të kësaj anomalie. Së bashku me Menaxherin e Njesisë Operative në Kamenicë është dakorduar që të zhvillohen aktivitete konkrete, duke filluar nga leximi i ujëmatësve individuale përmes aplikacionit për të siguruar lexime të sakta, inspektimi i pusetave të kanalizimit gjatë periudhës së natës (nga ora 02:00 deri në orën 06:00), kur hargjimet janë minimale, si dhe aktivitete të tjera sipas nevojës. Varësisht nga problemet e identifikuar, do të ndërmerren masat e nevojshme për zvogëlimin e UPF-së.
- Në sistemin “Kopërmicë dhe Kolloleq”, prodhimi është trefishuar, nga 7,720 m³ në TM2 të vitit paraprak në 21,290 m³ në TM2 2026. Në këtë sistem është eliminuar një defekt i madh, andaj nga muaji i ardhshëm nuk pritet të ketë prodhim kaq të lartë.
- Në total, në nivel rajonal, prodhimi në TM2 2026 krahasuar me TM2 2025 është rritur për 84,523 m³, çka tregon se prodhimi është duke u menaxhuar në mënyrë të kontrolluar. Përkatesisht, në disa sisteme prodhimi është zvogëluar, pasi po zbatohet menaxhimi i prodhimit sipas kërkesave të konsumatorëve. Vlen të përmendet se në FPU-Velekincë, duke filluar nga muaji nëntor 2025, përmes kontrollit të rezervuarit në Kodrën e Dëshmorëve, është

aritur që prodhimi të zvogëlohet për 31,168 m³, pavarësisht rritjes së numrit të konsumatorëve për 150, të cilët furnizohen me ujë nga ky rezervuar.

- Vetëm në gjashtë (6) fshatrat e Kamenicës dhe në Berivojcë (dy sistemet e marra në menaxhim gjatë vitit të kaluar) janë evidentuar gjithsej 77 defekte.

Nëse i referohemi Tabelës 37 të UPF-së për secilën komunë, vërehet se në Komunën e Kamenicës ka rritje të UPF-së në TM2 2026 krahasuar me TM2 2025, nga 50.4% në 61.94%.

Rritje të UPF-së ka edhe në Komunën e Ranillugut, megjithëse ndikimi është më i vogël për shkak të vëllimit më të ulët të prodhimit.

Në zonën e qytetit të Gjilanit, nga tri burimet kryesore, humbja është rritur nga 49.3% në 52.36%, ku, edhe pse kemi rritje të prodhimit të ujit për 31,826 m³, faturimi është më i ulët për 39,415 m³. Në zonën që furnizohet nga FPU – Velekincë kemi rritje të numrit të konsumatorëve në rrugët "Luan Haradinaj" dhe "Pajazit Ahmeti" (150 konsumatorë), gjë që do të duhej të reflektohej edhe në rritjen e faturimit.

Në Njësinë e Vitisë, niveli i UPF-së është pothuajse i njëjtë me periudhën paraprake.

Në kushte normale, rritja e prodhimit të ujit do të duhej të reflektohej në rritje proporcionale të faturimit. Megjithatë, pavarësisht rritjes së prodhimit prej 84,514 m³, faturimi ka shënuar rënie prej 32,979 m³.

Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve paraqet një faktor kyç në menaxhimin dhe uljen e ujit të pafaturuar (UPF). Fakti që sasia e faturuar rezulton për 32,979 m³ më e ulët krahasuar me periudhën paraprake, ndërkohë që prodhimi i ujit është rritur për 84,514 m³, tregon për mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet prodhimit dhe faturimit, duke ngritur dyshime mbi saktësinë dhe plotësinë e procesit të leximit.

Ekipi i kontrollit ka filluar me inspektimet në terren dhe vetëm gjatë muajit qershor ka identifikuar 34 kycje ilegale, prej të cilave 8 janë evidentuar në zonën e qytetit të Gjilanit.

Shënim:

Në periudhën në vijim, është e nevojshme të vazhdohet me zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit për Reduktimin e Humbjeve të Ujit, me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete deri në fund të vitit. Në këtë drejtim, do të identifikohen zonat me nivelin më të lartë të humbjeve, me fokus të veçantë në zonat ku është evidentuar ulje e faturimit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, si dhe në gjashtë (6) fshatrat e përfshira së fundmi në zonën e shërbimit të ndërmarrjes.

Po ashtu, kontrolli dhe monitorimi i prodhimit të ujit, veçanërisht në tri burimet kryesore të qytetit, mbetet me rëndësi të veçantë për menaxhimin efikas të sistemit. Për këtë arsye, instalimi i manometrave në pikat e ulëta dhe të larta të zonës së shërbimit konsiderohet masë e domosdoshme dhe urgjente, pasi mundëson monitorimin e presioneve në rrjet, optimizimin e operimit të sistemit dhe kontrollin më efektiv të prodhimit të ujit sipas nevojave dhe karakteristikave të secilës zone.

8.3 Divizioni për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit

Në përgjithësi, në zonat e shërbimit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 janë realizuar gjithsej 502 intervenime të natyrave të ndryshme, si rrjedhje dhe plasaritje të gypave në rrjet, dëmtime të valvulave etj.

Sipas njësive operative, shpërndarja e intervenimeve është si në vijim: në Njësinë Operative në Gjilan janë realizuar 310 intervenime, në Njësinë Operative në Kamenicë 151 intervenime, në Njësinë Operative në Viti 27 intervenime, në Komunën e Ranillugut 10 intervenime dhe në Komunën e Novobërdës 4 intervenime. Ndërsa, në Komunën e Parteshit nuk është regjistruar asnjë intervenim në rrjetin e ujësjellësit.

Tabela 38. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM2/2026

Zona e shërbimit	Numri i defekteve	Lagjet/rrugët/vendbanimet	Natyra e defekteve
------------------	-------------------	---------------------------	--------------------

Gjilan	310	Prill Fshatrat: Velekincë, Përlepnice, Shillovë, Kufcë e Epërme, Malishevë, Dobërçan, Makresh, Zhegër, Pasjan dhe Llovcë. Rrugët: Rr. "Shadërvani", Rr. "Afrim Gagica", Rr. "Vëllezërit Maliqi", Rr. "Hetem Haziri", Rr. "Hysen Tërpeza", Rr. "Nëna Terezë", Rr. "Ahmet Krasniqi", Rr. "Isuf Pidiqi", Rr. "Binaze Kacabaqi", Rr. "Abdullah Tahiri", Rr. "Halim Aga", Rr. "Kumanovës", Rr. "Mustafë Koka", Rr. "Kadri Halimi", Rr. "15 Qershor", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Martirët e Gjilanit", Rr. "Apollonia", Rr. "Ramadan Salihu", Rr. "Lidhja e Prizrenit", Rr. "Isa Boletini", Rr. "Fadil Jakupi", Rr. "Binak Aliu", Rr. "Nekibe Kelmendi", Rr. "Niket Dardani" dhe Rr. "Elena Gjika", etj. Maj Fshatrat: Livoq i Ulët, Zhegër, Përlepnice, Shillovë, Velekincë, Kufcë e Epërme, Malishevë, Dobërçan, Makresh, Pasjan dhe Llovcë. Rrugët: Rr. "Ahmet Krasniqi", Rr. "Murat Kryeziu", Rr. "Kumanovës", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Dajti", Rr. "Abdullah Presheva", Rr. "Bajram Llovca", Rr. "Sadik Sadiku", Rr. "Beqir Musliu", Rr. "Fehmi Agani", Rr. "Apollonia", Rr. "Bulevardi i Pavarësisë", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Dalmatët", Rr. "Sali Salihu", Rr. "Valbona", Rr. "Gjinollët", Rr. "Mustafë Koka", Rr. "Muharrem Kurteshi", Rr. "Dervish Cara", Rr. "Beqir Kastrati", Rr. "Vëllezërit Hyseni", Rr. "Limon Staneci", Rr. "Bregu i Djegun", Rr. "Vehbi Ibrahim", Rr. "Abdullah Tahiri", Rr. "Hasan Remniku" dhe Rr. "Raif Halimi", etj. Qershor Fshatrat: Zhegër, Malishevë, Përlepnice, Shillovë, Velekincë, Kufcë e Epërme, Dobërçan, Makresh, Pasjan dhe Llovcë. Rrugët: Rr. "Zija Shemsu", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Haki Myderizi", Rr. "Selman Riza", Rr. "Sadulla Brestovci", Rr. "Imer Molla", Rr. "Vëllezërit Frashëri", Rr. "Woodrow Wilson", Rr. "Isa Boletini", Rr. "Kumanovës", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Abdullah Presheva", Rr. "Lufta e Gjilanit", Rr. "Apollonia", Rr. "Haqif Tetova", Rr. "Gjinollët", Rr. "Xhevat Ajvazi", Rr. "Marie Shllaku", Rr. "Xheladin Kurbaliju", Rr. "Nexhat Orana", Rr. "Lekë Dukagjini", Rr. "Abdullah Tahiri", Rr. "Skifter Arifi", Rr. "Murat Bresalci", Rr. "Ibrahim Rugova", Rr. "Hysen Tërpeza" dhe Rr. "Nekibe Kelmendi", etj.	Rrjedhje në rugë (175) dhe rrjedhje në puseta (135).
Novobërdë	4	Fshati: Makresh	Rrjedhje në rugë (2) dhe rrjedhje në pusetë (2).

Ranillug	10	Fshatrat: Ranillug, Ropotovë, Glogovc.	Rrjedhje në rrugë (3) dhe rrjedhje në pusëtë (7).
Kamenicë	168	Fshatrat: Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Topanicë, Koretin, Kopërmicë, Roganë, Hodonoc dhe Muçivercë. Rrugët: Rr. "Ilir Konushevci", Rr. "Mulla Shefkriu", Rr. "Muharremi i Hoxhës", Rr. "Mërgimi", Rr. "Basri Canolli", Rr. "Musli Imeri", Rr. "Hafiz Ali Korça", Rr. "Doruntina", Rr. "Hysen Krasniqi", Rr. "Rinor Nas Spahiu", Rr. "Beteja e Kikës", Rr. "Sahit Baliqi", Rr. "Gjon Sereqi", Rr. "Pirroja", Rr. "Mujo Ulqinaku", Rr. "Fotoshka", Rr. "Nexhmedin Kuqi", Rr. "Ali Hadri", Rr. "Celula e UÇK-së", Rr. "Aziz Kelmendi", Rr. "Car Llazari", Rr. "Dedë Gjon Luli", Rr. "Xhaxhi", Rr. "Vlora", Rr. "Skënderbeu", Rr. "Qerçiz Topulli", Rr. "Avdulla Kastrati", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Musli Imeri", Rr. "Udha e Shkronjave", Rr. "Kryeziu", Rr. "Mic Sokoli", Rr. "Besnik Morina", Rr. "Sylejman Vokshi", Rr. "Fehmi Agani", Rr. "Vudro Vilson", etj.	Rrjedhje në rrugë (61), rrjedhje në pusëtë të ujëmatësve (90), shkqyje nga rrjeti (2), verifikime (9) dhe zhvendosje e ujëmatësve (6).
Viti	27	Fshatrat: Pozhoran, Sllatinë, Ramnishtë, Sadovinë e Çerkezëve, Sadovinë e Jerlive dhe në qytet.	Rrjedhje në rrugë (22) dhe rrjedhje në pusëtë (5).
Totali: 502			

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, ndërprerje të ujit për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ka pasur në:

- lagjen "Zabeli", "Arbëria", si dhe në rrugët "Lidhja e Prizrenit", "Gjinollët", "Lufta e Gjilanit" dhe "Kufca", furnizimi me ujë është ndërprerë për rreth nëntëmbëdhjetë (19) orë për shkak të defektit në gypin kryesor.
- lagjen "Zabeli", "Arbëria", si dhe në rrugët "Lidhja e Prizrenit", "Gjinollët", "Lufta e Gjilanit" dhe "Kufca", furnizimi me ujë është ndërprerë për rreth tri (3) orë për shkak të defektit në gypin kryesor.
- lagjen "Dardania", furnizimi me ujë është ndërprerë për rreth katër (4) orë për shkak të defektit në gypin kryesor.
- rrugën "Nexhat Orana", furnizimi me ujë është ndërprerë për rreth katër (4) orë për shkak të defektit në gypin kryesor.
- rrugën "Raif Halimi", furnizimi me ujë është ndërprerë për rreth katër (4) orë për shkak të defektit në gypin kryesor.

Shënim: Për shkak të natyrës së punës të evitimit të rrjedhjeve, shumica e defekteve janë evituar në shtypje pa e ndalë ujin fare, këto raste janë kur defektet janë në profil të gypit të vogël ose kur nuk është i dëmtuar gypi shumë.

8.3.1. DMA – zonat

Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjilanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2;
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;
4. Kmetovc dhe Verbicë e Kmetovcit;
5. Shillovë e Muhaxherëve dhe
6. Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekinca dhe Bregu i Djegun.

Tabela 39. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM2/2026 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit

ANALIZA , prodhimi, faturimi dhe UPF – TM2/2026 në DMA zonat	Prodhimi TM2/2026	Faturimi TM2/2026	UPF [%] TM2/2026	Prodhimi TM2/2025	Faturimi- TM2/2025	UPF [%] TM2/2025
Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10	62,240	135,666	28.1	56,629	132,620	52.1
Lagjja "Bregu i Djegun" (te ish kombinati i duhanit)	15,732			15,159		
Rr. "Hysen Tërpeza"	18,026			6,595		
Lipovicët	5,154			25,025		
Mbrapa shkollës në Velekinçë DN 63	1,831			8,061		
Velekinçë DN 90	0			63,275		
Rr. "Mulla Idrizi"	81,000			97,295		
Rr. "Esat Berisha"*10	4,782			4,678		
Shillova 1	1,374	1,617	48.73	1,033	2,050	45.72
Shillova 2	1,780			2,744		
Kmetovc	16,339	11,039	32.4	19,678	9,612	51.2
Kufcë e Epërme	0	4,609		5,564	5,547	0.3
Livoç i Ulët	32,986	14,057	57.4	34,378	16,113	53.1
Lagjja "Dardania 1" *10	71,081	58,191	52.9	67,079	67,317	39.1
Lagjja "Dardania 2" *10	52,455			43,437		
Prodhimi total m³/muaj:	364,780	225,179	38.3	450630	233,259	48.2

Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA:
Berivojcë – Lagjja Iliria

Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:

1. Pozhorani
2. DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë.

8.4. Divizioni për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 501 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Tabela 40. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2026

Njësia	Numri i Intervenimeve	Përshkrimi
Gjilan	2	Vendosje e kapakëve të pusetave
	14	Intervenime me autocistemë
	2	Intervenime me sajle dore
	2	Vendosje e unazave
	395	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave
Viti	46	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Novobërdë	/	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave
Partesh	/	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave
Kamenicë	40	Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave
Total:	501	

Tabela 41. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2026

Muaji	Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (km)	Pastrim i pusetave (copë)
Prill	11.7 km	390
Maj	14.1 km	470
Qershor	19.2 km	641
TOTALI	45.03 km	1501

8.5 Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve

8.5.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026

Gjatë periudhës së tremujorit të dytë të vitit 2026, Divizioni për Planifikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela 42. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM2/2026

	Aktivitet	Numri i aktiviteteve
1.	Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm	12
2.	Pëlqim në parim për banim individual	30
3.	Pëlqim në parim për institucione	3
4.	Evidentimi i intervenimeve në GIS	245
5.	Insertimin e kërkesave të reja për kyçe në rjetin e ujësjellësit	71
6.	Vlerësim të ofertave në Prokurim	7
7.	Menaxhim dhe mbikëqyerje të kontratave	5
8.	Inçizimi i rjetit të kanalizimit fekal (puseta)	501

Përveç këtyre aktiviteteve të paraqitura në tabelë, zyrtarët nga Divizioni i Planifikimit janë të angazhuar edhe në tri projekte të rëndësishme në zhvillimin e kompanisë siç janë:

8.5.2 Projekti FLOWS (Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit)

Pako 1

Gjatë tremujorit të dytë të vitit janë realizuar aktivitete të rëndësishme në kuadër të punimeve të projektit. Në Linjën 1 – Seksioni A janë instaluar 626 m gyp DN 630, ndërsa në Linjën 2 – Seksioni B janë instaluar 212 m gyp DN 315 dhe kanë filluar punimet e asfaltimit. Në Linjën 3 – Seksioni B janë zhvilluar punime për vendosjen e pusetave, duke përfshirë punimet e dheut, vendosjen e fazonerisë, punët e amimit dhe betonimit për pusetat e ajrit dhe ato lëshuese (të pastrimit).

Në rezervuarin në Përlepnice janë zhvilluar punime intensive në dhomat e lagështa, duke përfshirë prerjen, përgatitjen dhe vendosjen e armaturës, pahitë, instalimin e bllokuesve të ujit dhe betonimin e pllakës së themelit për dhomat “1-A” dhe “2-A”. Gjithashtu, është vazhduar me instalimin e pajisjeve prej hekuri duktil DN 200 dhe DN 400.

Në stacionin e pompimit në Përlepnice janë kryer punime renovimi dhe hidroizolimi të kulmit, si dhe janë zëvendësuar dy pompat ekzistuese.

Pako 2

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 janë instaluar afërsisht 8,395 m rjet i ri i ujësjellësit me diametër DN 63 deri në DN 900, në zonën e Kamenicës.

8.5.3 Projekti ITUN (Implanti i Trajtimt të Ujërave të Zeza)

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 kontraktori ka njoftuar për pezullimin e punimeve në terren për shkak të vonesave në kryerjen e pagesave. Me kërkesë të KRU Hidromorava Sh.A., më 02.04.2026 është mbajtur një takim koordinues ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, KRU Hidromorava Sh.A. dhe mbikëqyrësit të punimeve, në të cilin janë diskutuar masat për përshpejtimin e procesit të pagesave.

Raport për Menaxhimin e Rreziqeve për TM2/2026

KRU "Hidromorava" Sh.A, Gjilan, ofron shërbime për furnizim me ujë të pijes dhe ujra të ndotura, në shtatë komuna të Kosovës, ku përfshihen: Gjilani, Vitia, Kamenica, Novobërda, Ranillugu, Kllokoti dhe Parteshi, për të cilat shërbime e ka të rregulluar veprimtarinë sipas legjislacionit dhe politikave të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Përkundër rregullave të definuara për ofrimin e shërbimeve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kompania, ballafaqohet me rreziqe të natyrave të ndryshme, të cilat paraqesin pengesë në arritjen e objektivave të parapara në Planin e Biznesit.

Me Planin vjetor të Biznesit, Kompania i ka të definuara Misionin, Vizionin dhe Objektivat, për çka edhe ekziston, por njëkohësisht angazhimin e vet e bën po ashtu për të ofruar shërbime sipas mundësive, për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve në punë dhe ofrimin e shërbimeve të sigurta. Duke pasur parasysh rëndësinë e angazhimeve të përmendura dhe pengesat të cilat mund të shfaqen e që shkaktojnë rreziqe, kompania, ka ndërmarrë një sërë veprimesh të caktuara, të cilat kanë pasur për qëllim kryesor parandalimin dhe evitimin e tyre. Veprimet e ndëmarra kanë për qëllim funksionimin normal dhe avancimin e kualitetit të ofrimit të shërbimeve dhe qëndrueshmërinë financiare si dhe furnizimin me ujë 24/7. Duke pasur parasysh rëndësinë e identifikimit të rreziqeve dhe rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve të qëlluara me kohë, ndër veprimet kryesore që i ka ndërmarrë, ka përfshirë identifikimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve gjatë tërë ciklit të zhvillimit të veprimtarisë.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë TM2 të vitit 2026 në Ndërmarrje nuk janë identifikuar elemente të rrezikut të mashtrimit dhe korrupsionit. Gjatë kësaj periudhe, proceset e brendshme janë zhvilluar në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret në fuqi, ndërsa mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes kanë funksionuar në mënyrë efektive, duke kontribuar në parandalimin e çdo forme të mundshme të keqpërdorimit.

Në tabelën në vijim janë përshkruar të gjitha rreziqet e identifikuara, si dhe plani për menaxhimin e tyre:

Lista e Rreziqeve TM2/2026

1	Gjendja jo e mirë e infrastrukturës ekzistuese, si Impiantet e trajtimit të ujit, stacionet e pompimit, gypat transportues, gypat shpërndarës, UM e konsumatorëve të vjetër etj.
2	Ndërprerjet e ujit për shkak të defekteve si dhe për shkak të mungesës së ujit dhe kualitetit të ujit sipas standardeve të parapara
3	Ekspozim ndaj ujërave të ndotura dhe rrezik biologjik (baktere, viruse).
4	Ndërprerje e furnizimit me ujë për shkak të defekteve teknike (më pak se 6 orë).
5	Nevoja për sigurimin e burimeve financiare për investimet e nevojshme në ritjen e kapaciteteve të ujit si dhe në rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese.
6	Rrezik në punë për shkak të terreneve malore të sistemeve të ujit
7	Vazhdimësia e humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale, që është një ndër sfidat kryesore të kompanisë
8	Numri i madh i sistemeve të ndara, të furnizuara me puse të veçanta që risin koston e mirëmbajtjes dhe vështirësojnë operimin
9	Mungesa e stafit profesional në zbatimin e detyrave sipas reformave që do të pasojnë në sektor dhe plotësimin e obligimeve që duhet të zbatohen. Nga tani mungesa e një zyrtari të GIS, pasi ka dhënë dorëheqje zyrtari aktual. Për shkak të shtimit të volumit të punimeve, mungesa e një inxhinieri në divizionin e planifikimit
10	Gjendja teknike e mjeteve të punës, mungesë e mjeteve të punës si cisterna, eskavatorë, pajisje për detektim të humbjeve etj.
11	Tejkalim i afateve dhe kostove të projekteve.
12	Rrezik nga përdorimi i automjeteve dhe makinerive të rënda.
13	Stres profesional dhe lodhje nga ngarkesa e lartë e punës.

14 Mungesë trajnimi adekuat për teknologji dhe pajisje të reja.

Nr.	Lista e Rreziqeve 2026	Mundësia	Ndikimi	Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra / Arsyeja e pazbatimit	Dëshmitë	Plani i veprimit
1	Gjendja jo e mirë e infrastrukturës ekzistuese	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm ☐ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Përkundër ndërhyrjeve-mirëmbajtjes emergjente nga ekipet teknike, rreziku mbetet, për shkak të mungesës së investimeve afatgjate kapitale dhe buxhetit të limituar	-gypa të vjetër AC -Pajisjet e vjetruara në ITU, SCADA e vjetruar etj. -UM të vjetruar të konsumatorëve	Plani i biznesit ku parashihen: -Investime kapitale -investime në mirëmbajtje të infrastrukturës -Investime në makineri etj.
2	Ndërprerjet e ujit (defekte/mungesë) dhe kualiteti i ujit sipas standardeve të parapara	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Mungesë e investimeve	-Ndërprerjet e furnizimit me ujë për shkak të defekteve të shpeshta në rrjet -cilësia e ujit nuk i plotëson standardet e parapara, për shkak të turbullirës në disa burime, ndotjes së ujit nga ndërprerjet e ujit për shkak të defekteve etj.	Plani i veprimit të humbjeve të ujit Plani i sigurisë së ujërave
3	Ekspozim ndaj ujërave të ndotura dhe rrezik biologjik (baktere, viruse)	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Marrja e masave për uljen e rrezikut duke përdorur mjetet adekuate mbrojtëse. Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse shpesh shihen si të panevojshme dhe nuk përdoren edhe nëse i kemi në dispozicion.	-zbrazja e ujërave të zeza në lumenj që paraqet kërcënim serioz për shëndetin publik dhe mjedisin -Pastrimi i pusetave të ujërave të zeza nga ekipet teknike	-Kontrolli nga personat përgjegjës për siguri në punë Detyrimi i përdorimit të pajisjeve mbrojtëse -ngritja e vetëdijes për mbrojtje nga rreziqet e mundshme nga ndotja etj.
4	Ndërprerje e furnizimit me ujë për shkak të defekteve teknike	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Rrjet i vjetruar, pajisje të vjetruara në ITU etj.	Në TM2 kemi pasur ndërprerje të ujit për shkak të defekteve të shkaktuara në rrjet	Plani i Menaxhimit të aseteve Plani i Veprimit për kyçe ilegale

		se ☐ Rrallë				
5	Nevoja për sigurimin e burimeve financiare për investimet e nevojshme në rritjen e kapaciteteve të ujit si dhe në rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☐ Mesatar ☒ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Nevoja për plane qeveritare të investimeve kapitale afatmesme dhe afatgjata	Edhe përkundër investimeve të shumta nga niveli qendror, donator dhe investime vetanake, nevojiten investime të mëdha në sigurimin e kapaciteteve të burimeve të ujit dhe në rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese	Kompania ka një plan të menaxhimit të thatësisë, të cilin e zbaton në periudhat e thatësisë -Projekti WRISP, financiar nga Banka Botërore, që është në proces.
6	Rrezik në punë për shkak të terreneve malore të sistemeve të ujit	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Rrezik me ndikim të jashtëm	Ekzistojnë terrene të vështira, për mirëmbajtje	Pajisje adekuate mbrojtëse
7	Vazhdimësia e humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale, që është një ndër sfidat kryesore të Ndërmarrjes	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm ☐ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	-Riparimi i defekteve me kohë -Investimet në rehabilitim të rrjetit sipas PMA -zëvendësimi i pompave të vjetra me ato reja eficiente në sisteme pompimi etj. -Zëvendësimi i UM të vjetër etj.	Humbjet teknike mbi 50% dhe kycjet ilegale.	Plani i veprimit për humbje të ujit dhe zbulim i kycjeve ilegale
8	Numri i madh i sistemeve të ndara, të furnizuara me puse të veçanta që rrisin koston e mirëmbajtjes dhe vështirësojnë operimin	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Mungesa e një akumulacioni të madh (pendë), i cili do të përfshinte të gjitha vendbanimet.	Numri i madh i sistemeve të ujës-jellësit (28 sisteme), kanë shpenzime operative të mëdha dhe është më vështirë për operim	Në proces nga niveli qendror Lepenci
9	Mungesë stafi profesional në zbatimin e detyrave sipas reformave që do të pasojnë në sektor dhe plotësimin e	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☐ Mesatar ☒ I vogël ☐ I papërfillshëm	Rrezik me ndikim të vogël, pasi që politikat e ndërmarrjes parashohin edhe trashëgiminë e njohurive dhe mbulimin e pozitave	Konkurse të vazhdueshme-shpesh mosinteresim për aplikim në pozita të caktuara	Punësim të stafit ekzekutiv profesional. Shkollim dhe trajnim i brendshëm i stafit ekzistues. Rreziku për vazhdimësinë e

	obligimeve që duhet të zbatohen	se ☐ Rrallë		ekzekutive profesionale e strategjike për funksionimin e ndërmarrjes.		pozitive me punësime të reja me shumë vjen nga leverdia për të qenë në këto pozita nga profesionist të rinj për shkak të pagave solide të vogla.
10	Gjendja teknike e mjeteve të punës, mungesë e mjeteve të punës si cisterna, ekskavatorë, pajisje për detektim të humbjeve, etj.	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Edhe përkundër investimeve të vazhdueshme në ripërtëritjen e pajisjeve dhe makinerisë, rreziku është i mesëm, pasi që ndërmarrja posedon mjete operative të pamjaftueshme, posedon makineri me vjetërsi relativisht të lartë dhe në gjendje të amortizuar, të cilat kanë mundësi mesatare riparimi për shkak të faktorëve të shumtë. Këto mjete ndikojnë drejtpërdrejtë në operimin e ndërmarrjes në rast të prishjeve ose mungesës së investimeve.	-për momentin KRU ka vetëm një ekskavator dhe një në proces të tenderimit -kombi për punë etj.	Investime kapitale/riparimi i mjeteve dhe pjesë rezervë
11	Tejkalim afatesh dhe kostove të projekteve	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	-Për shkak të procedurave të prokurimit dhe gjendjes së panjohur të infrastrukturës nëntokësore, e cila është instaluar shumë vite më parë. -ndryshimi i çmimeve etj.	Përsëritja e proceseve të tenderimit për shkak të mosaplikimit të OE -Dërgim i lëndëve në OSHP -Dërgimi i lëndëve në OSHP etj.	Përmirësim i përgatitjeve të specifikave teknike dhe koordinim me institucione të tjera
12	Rrezik nga automjetet dhe makineritë	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël	Në vazhdimësi, pajisja me automjete të reja dhe të sigurta për punë.	automjete dhe makineri të vjetruara të cilat kanë defekte të shpeshta	Pajisje/makineri të sigurta të punës

		☒ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ I papërfillshëm			
13	Stres profesional dhe lodhje nga ngarkesa e lartë e punës	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Ngarkesë e lartë pune, me theks të veçantë në ngarkimin me punë dhe caktimin <i>ad hoc</i> (aty për aty) të detyrave të punës.	-takimi me konsumatorë me ankesa të ndryshme -imela të shumta nga institucione të shumta, të cilat kërkojnë kthim të përgjigjeve me afat të caktuar etj.	Në fund të vitit 2025 është zhvilluar testi i ergonomisë nga Zyrtari për Siguri dhe shëndet në punë për ta parë nivelin e ndikimit të kushteve të punës dhe stresit në shëndetin e të punësuarve. Pas përfundimit janë dhënë rekomandimet dhe janë propozuar masat të cilat duhet të ndëmerren për përmirësimin e kushteve të punës.
14	Mungesë trajnimi adekuat për teknologji dhe pajisje të reja	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Kufizime buxhetore.	*Stafi ka nevojë të trajnohet për përdorimin e pajisjeve për detektim të humbjeve, të cilat I kemi në dispozicion, etj. -Trajnim për shfrytëzimin e programeve të ndryshme etj.	Plani i Biznesit
15	Hapja e pushtave të rënda paraqet rrezik lëndimi	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm ☐ Mesatar ☐ Vështirëse ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	-rregullimi i pushtave të konsumatorëve dhe kapakëve të pushtave të kanalizimit, të përshtatshme për operim	-Lëndimi i punëtorëve gjatë leximit të UM	- Gjatë investimeve në zëvendësimin e gypave, tani e tutje bëhet edhe zëvendësimi i pushtave të UM
16	Kërcënime nga konsumatorët / borbhlinjtë	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël	Konflikte në terren	N/A	Punë në ekipe

		☐ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ I papërfillshëm			
17	Temperatura ekstreme	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Kushte klimatike	N/A	Orar flrksibël
18	Mos-konsum nga rrjeti	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Burime alternative	N/A	Analiza & kontrolle
19	Rritja e çmimeve / inflacioni	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm ☐ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Rritje kostosh	N/A	Kontrolli buxheti
20	Thatësira verore	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Mungesë uji	N/A	Plan menaxhimi
21	Mungesë sigurie në objekt	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Mungon zyrtari për sigurim fizik. Sistemi i kamerave është funksional por nuk shërben si preventive në rastet e rrezikut potencial nga personat	N/A	Rekrutimi i zyrtarit për siguri (rojtar) në objektin e Administratës.

		se ☐ Rrallë		fizik/konsumatorët potencial.		
22	Vjedhje e pazarit ditor	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Menaxhim i parasë	N/A	Kontroll & kamera
23	Monedha false	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☐ Madhor ☒ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Pranim i parasë false	N/A	Pajisje verifikimi
24	Rritja e shpenzimeve operative	☐ Sipas të gjitha gjasave ☒ I mundshëm ☐ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Rritja e kostove totale operative rrezikon likuiditetin dhe buxhetin dhe realizim të objektivave financiar	N/A	Optimizimi i konsumit të energjisë kontroll më i rreptë i shpenzimeve neper pika te prodhimit , planifikim më i mirë i buxhetit
25	Amortizimi i aseteve	☐ Sipas të gjitha gjasave ☐ I mundshëm ☒ Mesatar ☐ Vështirë se ☐ Rrallë	☐ Serioz/Fatal ☒ Madhor ☐ Mesatar ☐ I vogël ☐ I papërfillshëm	Vjetërsi e asetëve shkakton rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes, ulje e efikasitetit operacional	Pasqyrat financiare ku evidentohet amortizimi	Implementimi i planit afatmesëm dhe afatgjatë të investimeve kapitale



Raport i punës për tremujorin e dytë të vitit 2026



U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve
KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan


z. Habil Zeqiri

